



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. 2998 Prot.

Vau Dejes me 02.05.2024

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në Rregulloren e Brendshme për Funkcionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e Bashkisë Vau Dejës të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e mëposhtëm:

“Projekt vendim për miratimin e planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Vau Dejës” .

(Paraqitur nga Drejtoria e ndihmes ekonomike arsimit rinisë dhe sportit, sektori i arsimit rinisë dhe sportit)

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **30.05.2024 ora 10.30**, Njësia Administrative Bushat (salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjesës për projekt vendimin e mësipërm, nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

(info@vaudejes.gov.al , ardian.celepija@vaudejes.gov.al, facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

SEKRETARI I KËSHILLIT

Ardian CELEPIJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE ARSIMIT RINISË DHE SPORTIT
SEKTORI I ARSIMIT RINISË DHE SPORTIT

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

PROJEKT VENDIM

Nr. 1 datë 29.4. 2024

PER MIRATIMIN E "PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR
ARSIMIN PARASHKOLLOR NË BASHKINË VAU DEJËS"

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës _____.____.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 8, neni 23 pika 12, neni 54 pika k, Ligjin nr. 69/2018 "Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Vau Dejës.

VENDOSI:

1. Të miratojë "Planin e Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Vau Dejës" sipas dokumentit bashkëlidhur pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, sipas strukturës organizative dhe përgjegjësisë së tyre.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Aleksandra Gjoni



Konceptoi: Melita Vjerdha (Përgjegjës, Sektori i Arsimit)
Miratoi: Devis Peci (Drejtore Drejtorie)

RELACION

PËR MIRATIMIN E "PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR NË BASHKINË VAU DEJËS"

Në vitin 2015, gjatë periudhës së ndryshimeve politike në Shqipëri, u ndërmorën reforma të rëndësishme që prekjin strukturën e Bashkive në vend. Këto ndryshime organizative sollën krijimin e 61 Bashkive të reja, duke sjellë me vete sfida të shumta administrative dhe organizative. Këto transformime u realizuan në përpjekje për të decentralizuar më tej pushtetin lokal dhe për të përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqënie-sociale dhe ekonomike në nivel lokal.

Në lidhje me arsimin parashkollor, Bashkia Vau Dejës mori përsipër përgjegjësinë për zbatimin dhe përmirësimin e këtij sektori në territorin e saj. Pas një eksperience pune të vjetër në ofrimin e shërbimit të Arsimit Parashkollor, tashmë duke njohur mirë nevojat dhe sfidat Bashkia Vau Dejës, ka punuar për një plan të qartë afatmesëm për përmirësimin në vijim të shërbimit për të adresuar nevojat dhe sfidat në kopshte.

Procesi i hartimit të Planit të Përmirësimin të shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Vau Dejës (në vijim referuar si Plani) është mbështetur nga Projekti "Bashki të Forta" i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Swiss Development & Cooperation) i zbatuar nga Helvetas, përmes asistencës teknike të ofruar nga Smart Processes shpk.

Qëllimi i planit është të përmirësojë cilësinë e arsimit parashkollor në Bashkinë Vau Dejës, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe krijimin e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit parashkollor. Plani synon të harmonizojë aktivitetet në një vizion të përbashkët dhe koherent, duke përfshirë bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin.

Dokumenti gjithashtu përfshin një analizë përmbajtësore e cila përfshin Vizionin, Misionin, dhe Objektivat Strategjike të Planit, duke përcaktuar gjithashtu personat përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e tij. Pjesa e dytë e dokumentit fokusohet në vendosjen e objektiveve specifike për secilin proces dhe përcaktimin e treguesve të performancës për t'u përdorur për monitorim. Në pjesën e tretë, paraqitet buxheti i nevojshëm për të realizuar ndërhyrjet në terren për rritjen e cilësisë së arsimit parashkollor.

Plani është shtrirë në të gjitha kopshtet nën juridiksionin e Bashkisë Vau Dejës dhe do të monitorohet nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Zhvillimit të Turizmit me qëllim përmirësimin e shërbimeve arsimore të parashkollor për të gjithë fëmijët në këtë zonë.

Plani i Përmirësimin të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Vau Dejës përqendrohet në Proceset e Menaxhimit të shërbimit në arsimin parashkollor, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe organizimit efektiv. Planifikimi dhe kontrolli i cilësisë janë thelbësore për këtë qëllim, duke përfshirë planifikimin e numrit të fëmijëve në kopshte dhe vlerësimin e infrastrukturës së nevojshme. Objektivat kryesore të planit përfshijnë rritjen e regjistrimeve dhe frekuencimit në kopshte të vajzave dhe djemve, fuqizimin e strukturave të

kopshteve dhe sigurimin e një shpërndarje të barabartë të fëmijëve. Në një periudhë tre vjeçare, Plani prezanton sfidat dhe mundësitë specifike të regjistrimit të fëmijëve, duke përfshirë nevojën për të identifikuar nevojat e komunitetit dhe për të përdorur teknologjinë për të përmirësuar menaxhimin e të dhënave. Lista e aktiviteteve përfshin projekte si punësimi i specialistëve për arsimin parashkollor, vlerësimin e brendshëm kopshteve, themelinin dhe funksionalizimin e organizmave të institucionit arsimor si bordi i kopshtit, këshilli i prindërve, Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, si dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin dhe prindërit për të përmirësuar shërbimin.

Plani i Përmirësimit të Shërbimit synon të adresojë Proceset Kryesore dhe të përmirësojë shërbimin për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe me aftësi të kufizuara në kopshtet publike të Bashkisë Vau Dejës. Qëllimi kryesor është të rritet identifikimi, vlerësimi dhe trajtimi më i mirë i këtyre rasteve në mënyrë që të sigurohet një shërbim cilësor dhe i plotë për fëmijët në nevojë.

Për të arritur këtë qëllim, plani ka disa objektiva të përgjithshëm, si rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimi i procesit të menaxhimit të këtyre rasteve. Në mënyrë specifike, për të adresuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, plani synon të përmirësojë procesin e diagnostikimit të tyre dhe të sigurojë infrastrukturë të përshtatshme në kopshte për t'i bërë ata të aksesueshëm.

Në të njëjtën kohë, plani përfshin ndihmë të përditshme për të gjithë fëmijët në nevojë, përfshirë mbështetje ushqimore, trajtim psikologjik, si dhe ndërhyrje ligjore në rastet e nevojshme. Përveç kësaj, synohet edhe hartimi dhe zbatimi i politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucionet arsimore dhe përmirësimi i bashkëpunimit mes strukturave të shërbimit social të përfshira për të garantuar një trajtim të drejtë dhe të efektshëm për të gjithë fëmijët në nevojë.

Planifikimi dhe zbatimi i Proceseve Mbështetëse në Planin e Përmirësimit të Shërbimit për kopshtet publike të Bashkisë Vau Dejës është një pjesë kritike e përpjekjeve për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe cilësor për fëmijët. Këto procese janë themelore për arritjen e qëllimeve të përcaktuara, duke përfshirë trajnimin e stafit, përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve dhe sigurimin e materialeve didaktike. Qëllimi i Proceseve Mbështetëse është të ofrojnë mbështetje efektive për proceset kryesore të shërbimit në kopshte. Këto përfshijnë aspekte të rëndësishme si edukimi, siguria, zhvillimi dhe aksesueshmëria për të gjithë fëmijët.

Për të arritur këtë qëllim, objektivat kryesore përfshijnë plotësimin e standardeve të vendosura nga ligji për stafin e kopshteve, rikonstruksionin e godinave të kopshteve për të përmirësuar infrastrukturën dhe sigurimin e materialeve didaktike për të përmbushur nevojat e zhvillimit të fëmijëve. Në procesin e rekrutimit të stafit, janë parashikuar veprime specifike si punësimi i drejtorëve të kopshteve për të përmbushur standardin e një drejtori për çdo 5 grupe fëmijësh, duke respektuar udhëzimet ligjore. Gjithashtu, është parashikuar trajnimi i stafit për situata emergjente dhe për përdorimin e teknologjisë së informacionit, nëpërmjet bashkëpunimit me agjencitë përkatëse për sigurimin e trajnimeve të nevojshme. Për rikonstruksionin e godinave, janë identifikuar nevojat konkrete të kopshteve, duke përfshirë rikonstruksionin e tualeteve, rinovimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, si dhe sigurimin e materialeve të nevojshme për këtë qëllim. Në planifikimin e nevojave për materiale, është parashikuar hartimi i një liste të unifikuar të materialeve didaktike për të siguruar një standard të përshtatshëm për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve në kopshte.

Këto masa synojnë të sigurojnë një mjedis të sigurt, të përshtatshëm dhe cilësor për të gjithë fëmijët, vajza e djem, duke përbushur nevojat e tyre të edukimit dhe zhvillimit në mënyrë efektive.

Zbatimi i Planit do të kërkojë buxhet shtesë të nevojshëm për të realizuar të gjitha projektet e përfshira në Planin e Përmirësimit të Shërbimit. Buxheti shtesë përfshin fusha të ndryshme, duke përfshirë arsimin bazë dhe arsimin parashkollor, si dhe programe për kujdesin social të familjeve, fëmijëve dhe personave të sëmurë apo me aftësi të kufizuara: përkatësisht 19,099,500 lekë për vitin 2024, 20,368,000lekë për vitin 2025 dhe 19,538 lekë 2026.

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 8, neni 23 pika 12, neni 54 pika k, Ligjin nr. 69/2018 "Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, paraqesim projekt vendimin për shqyrtimin dhe miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në bashkinë Vau Dejës.

Konceptoi: Melita Vjerdha (Përgjegjës, Sektori i Arsimit)

Miratoi: Devis Peci (Drejtor Drejtorie)



**PLANI I PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT
PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR**

BASHKIA VAU I DEJËS

Mars 2024

Grupi i punës së Bashkisë Vau i Dejës për hartimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor u koordinua nga Melita Vjerdha, Përgjegjëse e Sektorit të Arsimit Bazë dhe Parashkollor, Bashkia Vau i Dejës.

Dokumenti u përgatit nga ekspertë të Smart Process, Tiranë

Procesi hartimit të dokumentit u koordinua nga Elvin Hoxha, Kordinator Rajonal Shkodër, Projekti Bashki të Forta - HELVETAS Swiss Intercooperaon, Tiranë, Albania

Hartimi i dokumentit u financua nga Qeveria Zvicerane përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe u zbatua nga Helvetas Swiss Intercooperacion Ky botim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC.



Përmbajtja

1. Hyrje	6
1.1 Qëllimi	6
1.3 Shtrirja.....	7
1.4 Vizioni.....	7
1.5 Misioni	7
1.6 Objektivat.....	7
1.7 Përgjegjësitë	7
2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	8
2.1 Qëllimi.....	8
2.2 Objektiva të përgjithshëm	8
2.3 Regjistrimi i fëmijëve	9
2.3.1 Planifikim dhe parashikim i regjistrimit të fëmijëve	9
2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor	27
2.4.1 Këshilli i Prindërve	27
2.4.2 Bordi i Kopshtit.....	33
2.4.3 Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit.....	41
3. Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit.....	47
3.1 Qëllimi.....	47
3.2 Objektiva të përgjithshëm	47
3.3 Fëmijët me aftësi të kufizuar.....	47
3.3.1 Kërkesa për fonde shtesë	47
4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	57
4.1 Qëllimi.....	57
4.2 Objektiva të përgjithshëm	57
4.3 Burimet Njerëzore.....	57
4.3.1 Rekrutimi i stafit	57
4.4 Menaxhimi i godinave	61
4.4.1 Rikonstruksioni i objekteve	61
4.5 Materialet	70
4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale	70

4.6 Ushqimi.....	73
4.6.1 Planifikimi i dietës dhe menysë	73
4.7 Buxheti.....	78

1. Hyrje

Në Shqipëri në vazhden e ndryshimeve politike, në 2015, u përfshinë edhe ndryshimet që lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me mënyrën e organizimit të Bashkive në Republikën e Shqipërisë. Si rezultat u krijuan 61 Bashki, të cilat përballen me ndryshime të shumta organizative dhe administrative. Në këtë Kuadër për shkak të decentralizimit Bashkive ju shtohen disa detyra, si dhe nevoja për t'ju përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqënie sociale dhe ekonomike.

Ndërkohë në bazë të ligjit 69/2018 të ndryshuar për Arsimin, bashkisë i kalon nën juridiksionin e saj çdo çështje që lidhet ngushtë me mbarëvajtjen e arsimit parashkollor. Në këtë kuadër Bashkia Vau Dejës harton planin strategjik me asistencën e projektit Bashki të Forta.

1.1 Qëllimi

Arsimi parashkollor, konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Vau Dejës. Bashkia ka nevojë të krijojë në organigramën e saj një sektor përgjegjës për Arsimin Parashkollor, për ofrimin e shërbimit cilësor në Arsimin parashkollor. Plani i përmirësimit synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjik.

Konkretisht nëpërmjet planit synohet përmirësimi i shërbimit në 3 drejtime:

- Planifikim strategjik përsa i përket riorganizimit të infrastrukturës së kopshtit, me qëllim përsimulimin e shërbimit në kopshtet që janë brenda shkollave, ose kopshteve që kanë nevojë imediate për restaurim;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore të bashkisë në çështje të arsimit parashkollor, përmes ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e drejtimit dhe administratës së bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të përmirësimit;
- Ngritja e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit parashkollor, sipas të cilës të sigurohet respektimi i kërkesave ligjore dhe kuadrit të brendshëm rregullator nga zyrtarët vendorë (autoritetet dhe administrata) si edhe përmirësimin dhe forcimin e këtij kuadri për të parandaluar dhe eliminuar shkeljet;

Në pjesën e parë të dokumentit gjendet një analizë përmbajtësore e cila do të përmbajë Vizionin, Misionin, Objektivat Strategjik të Planit, personat përgjegjës për implementimin, monitorimin dhe zhvillimin e tij.

Në pjesën e dytë dokumenti fokusohet në vendosjen e Objektivave të përgjithshëm dhe specifik për secilin proces. Për të lehtësuar procesin e implementimit të planit, janë vendosur edhe indikatorët e performancës si dhe objektivat specifik për secilin kriter të përgjithshëm.

Ndërkohë në pjesën e tretë janë zhvilluar projekte konkrete se si bashkia të realizojë ndërhyrjet në terren me qëllim rritjen e cilësisë në arsimin parashkollor.

1.3 Shtrirja

Plani synon të përmirësojë shërbimin e Arsimit Parashkollor në Bashkinë Vau Dejës. Plani do të implementohet në të gjitha kopshtet që ka nën juridikson Bashkia Vau Dejës. Për mbarëvajtjen e aktiviteteve në plan dhe monitorimin e tij do të kujdeset Personi Përgjegjës për Arsimin Parashkollor, pranë Drejtorisë së Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë Dhe Sportit në Bashkinë Vau Dejës.

1.4 Vizioni

Përmirësimi i shërbimit të Arsimit Parashkollor, nëpërmjet ngritjes së strukturave për arsimin parashkollor, dhe fuqizimin e tyre për t'ju përgjigjur nevojave të fëmijëve.

1.5 Misioni

Shtimi i ambienteve arsimore për arsimin parashkollor dhe përmirësimi i cilësisë së tyre për të ofruar shërbim cilësor për çdo fëmijë të arsimit Parashkollor.

1.6 Objektivat

- Përmirësimi i ofrimit të shërbimit në kopshte nëpërmjet organizimit të regjistrimeve sipas vendbanimeve;
- Përmirësimi i infrastrukturës së kopshteve, hapja e një kopshti me drekë;
- Ulja e numrit të grupeve të përziera në kopshte nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës;
- Ngritja dhe fuqizimi i strukturave mbështetëse të kopshtit (Bordi dhe KëshilliI prindërve, Komisionii shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit;
- Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, me aftësi të kufizuar dhe në nevojë për përfshirje sociale.

1.7 Përgjegjësitë

1. Koordinator i planit:
 - Personi përgjegjës për arsimin parashkollor, i cili kujdeset për zbatimin e planit nga të gjithë aktorët përgjegjës;
 - Personi përgjegjës për Njësinë e Shërbimit Social.
2. Aktorët zbatues të planit:
 - Drejtues kopshti;
 - Mësues i kopshtit;
 - Komuniteti;
 - PMF;
 - Psikolog;
 - GTN;
 - Grupet e terrenit.
3. Monitorues/vlerësues i planit:
 - Kryetari i Bashkisë;
 - Këshilli i Bashkisë.

2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

2.1 Qëllimi

Proceset e menaxhimit nuk janë pjesë e ekzekutimit të menjëhershëm të detyrave, por vendosin objektiva strategjike dhe kushte kuadër që ndikojnë në llojet e tjera të procesit. Këto përfshijnë planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë.

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetet në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit. Kjo përbën planifikimin e kërkesës së arsimit parashkollor, duke marrë parasysh që arsimi parashkollor nuk është i detyrueshëm në Shqipëri.

Procesi i parashikimit ka gjithashtu edhe dimensionin e ofertës, që përfshin vlerësimin e numrit të mësuesve të nevojshëm, drejtorëve, mësuesve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, stafit mbështetës, si dhe objekteve (mjediseve), stafit shtesë etj.

Plani i përmirësimit të shërbimit në Proceset e Menaxhimit ka si qëllim përmirësimin e shërbimit të kopshtit duke siguruar rritje të regjistrimeve në kopshtet nën kapacitet; ulje të numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në to, dhe themelimin dhe fuqizimin e organizmave brenda institucionit të kopshtit.

2.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivat kryesorë të këtij plani në lidhje me Proceset e Menaxhimit janë:

1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së tyre të banimit dhe rritja e regjistrimeve përmes ndërgjegjësimit të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijës;
2. Krijimi i konceptit të kopshtit si komunitet duke organizuar aktivitete në çdo kopsht ku komuniteti mund të marrë pjesë dhe rritja e angazhimit të komunitetit në përmirësimin e shërbimit të arsimit parashkollor;
3. Themelimi dhe fuqizimi i organizmave si: Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit dhe Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, në mënyrë që të rritet ndikimi i tyre në proceset e menaxhimit të kopshteve.

2.3 Regjistrimi i fëmijëve

2.3.1 Planifikim dhe parashikim i regjistrimit të fëmijëve

Informacion i përgjithshëm

Në Bashkinë Vau Dejës kemi gjithsej 20 kopshte publike. Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike të Bashkisë është 532, prej të cilëve 315 janë vajza. Rezulton që numri i vajzave është më i lartë se sa numri i djemve.

Në këtë bashki numri i fëmijëve të regjistruar është më i ulët se sa kapacitetet akomoduese të kopshteve.

Ndërkohë, sipas studimit numri më i madh i kopshteve ndodhet në territorin e Njësisë Administrative Bushat, ndërsa numri më i ulët i kopshteve ndodhet në **Njësinë Administrative Temal dhe Vig Mnelë** tek të cilat ka vetëm grupe të përziera.

Pothuajse të gjitha kopshtet kanë grupe të përziera ku ka fëmijë të të gjitha moshave. Nga analiza e të dhënave vihet re që numri i grupeve të përziera është i lartë. Kjo vjen si pasojë e numrit të ulët të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe krijimi i grupeve të përziera është zgjidhja më optimale për të garantuar ofrimin e shërbimit të kopshtit për ata fëmijë që regjistrohen.

Kopshtet brenda godinave të shkollave janë 15, të cilat kanë shpeshherë problematika të cilat lidhen me mënyrën e drejtimit, pasi nuk krijohen strukturat që e kërkon **Udhëzimi Nr. 31, datë 28.01.2020**. Kopshtet që nuk kanë drejtor monitorohen nga mësueset të cilat janë dhe përgjegjëse për këto kopshte.

Në rastet e tjera:

- 1) drejtuesi i shkolles është edhe drejtues i kopshtit, por sërish përgjegjësia për ta administruar është e bashkisë;
- 2) Sipas udhëzimi udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018: njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kopshtet që veprimtarinë e tyre e zhvillojnë pranë shkollave 9-vjeçare, mund të emërojnë një drejtues kopshti për jo më pak se 5 grupe nxënësish.

Objektiva kryesore:

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetur në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit për të siguruar një shërbim efikas.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Unifikimi i të dhënave të arsimit parashkollor mes Bashkisë, ZVAP, NJA dhe kopshteve
2	Ulja e numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në këto grupe
3	Rritja e regjistrimit të fëmijëve në kopshtet e NJA

Nr	Pershkrimi
4	Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti në Bashkinë e Vau Dejës

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
079	Sipërfaqja e brendshme e kopshtit në m ² /fëmijë	Qender	Vlere	Mesatare	2m ² per femije			
008	Numri i fëmijëve në grup-moshën 3-6 vjeç	Bashki	Vlere	Shumatore	875	875	870	870
002	Norma e regjistrimit në kopsht	Fshat	%	Mesatare	15			
002	Norma e regjistrimit në kopsht	Qender	%	Mesatare	20			
001	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopsht	Fshat	Vlere	Shumatore	532			
010	Numri i punonjësve në Njësinë që menaxhon arsimin parashkollor brenda Bashkisë	Bashki	Vlere	Shumatore	4	5	5	5
009	Instrumenta teknologjike për dixhitalizimin dhe menaxhimin e të dhënave	Bashki	Vlere	Shumatore	0	1	1	1

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Buxhet Vit 1	Buxhet Vit 2	Buxhet Vit 3
006	Punësimi i një specialisti pranë Sektorit të Arsimit vetëm për arsimin parashkollor	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	732,000	732,000	732,000
005	Vlerësimi i brendshëm i kopshteve	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	70,000	70,000	
004	Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo Kopsht	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	1,500		
003	Regjistrimi në kopsht sipas banimit	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
002	Krijimi i platformës digjitale e cila përmban të dhëna analitike për kopshtin	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	100,000	100,000	100,000
001	Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	10,000	10,000	10,000
Totali			913,500	912,000	842,000

Lista e projekteve

Nr. 001	Projekti: Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit nuk ka një listë të fëmijëve në moshë kopshti. Si pasojë, nuk mund të bëjë parashikime dhe të planifikojë saktësisht mbulimin me shërbim të kopshtit.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Duke mos pasur një numër të fëmijëve në moshë kopshti, nuk është e qartë norma e regjistrimit të fëmijëve në kopsht në raport me numrin e fëmijëve në moshë kopshti. Regjistrimi dhe frekuentimi në kopsht nuk janë të detyrueshëm, megjithatë arsimit parashkollor është shumë i rëndësishëm për formimin e fëmijëve. Aktualisht, është e vështirë të llogaritet norma e regjistrimit dhe të punohet për të rritur atë.</p>		
<p>Për shkak të numrit të vogël të fëmijëve të regjistruar në kopshtet e Njërive Administrative, formohen grupet e përziera. Aktualisht, numri i grupeve të përziera është më i lartë se numri i grupeve të I, II dhe III dhe numri i fëmijëve në këto grupe është i lartë. Ky fakt shkakton vështirësi në edukimin dhe menaxhimin e fëmijëve. Për shkak të mungesës së numrit të fëmijëve në moshë kopshti në Bashkinë Vau Dejës, nuk mund të kuptohet qartë se si mund të zgjidhet problemi i grupeve të përziera. Numri i ulët i regjistrimeve vjen si arsye e numrit të ulët të fëmijëve, por ka dhe arsye të tjera si infrastruktura e kopshtit dhe konceptimi i arsimit parashkollor si jo i rëndësishëm nga komuniteti. Për këtë arsye, është e vështirë të hartohet zgjidhja e duhur e këtij problemi.</p>		
ii Synimi i projektit		
<p>Një mënyrë për identifikimin e fëmijëve në moshë kopshti në Bashki është duke bashkëpunuar me Zyrën e Gjendjes Civile dhe Qendrat Shëndetësore. Bashkëpunimi me Zyrën e Gjendjes Civile do të mundësojë listën e fëmijëve të regjistruar në Gjendje Civile të moshës 3-5 vjeç sipas vendbanimit çdo vit. Nga Qendrat Shëndetësore mund të merren listat e fëmijëve të vaksinuar të moshës 3-5 vjeç sipas vendbanimit çdo vit. Nëpërmjet këtij projekti synohet që:</p>		
<ol style="list-style-type: none">1. Rritja e regjistrimit dhe frekuentimit të kopshtit nga fëmijët. Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit , pas përfundimit të regjistrimit të fëmijëve, mund të identifikojë fëmijët në moshë kopshti që nuk janë regjistruar. Në këtë mënyrë, drejtorët dhe mësueset e kopshteve mund të kryejnë takime me prindërit për të kuptuar arsyet e mos regjistrimit të fëmijëve të tyre në kopsht dhe informimin mbi rëndësinë e arsimit parashkollor të fëmijëve. Në këtë mënyrë, synohet të rritet numri i fëmijëve që regjistrohen dhe ndjekin kopshtin.2. Ulja e grupeve të përziera dhe e numrit të fëmijëve në grupet e përziera. Me rritjen e regjistrimit mund të ulët dhe numri i fëmijëve në grupet e përziera. Duke qenë se ato formohet kur numri i fëmijëve për të formuar grup të I, II dhe III nuk është i mjaftueshëm, rritja e normës së regjistrimit do të mundësojë zvogëlimin e numrit të		

grupeve të përziera dhe numrin e fëmijëve në këto grupe.

3. Lehtësim i procesit të regjistrimit të fëmijëve në kopsht sipas zonës së banimit. Duke pasur listat e fëmijëve në moshë kopshti sipas vendbanimit dhe moshës, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit mund ta ketë më të lehtë të marrë vendimin për regjistrimin ose jo të fëmijëve në kopshtet ku kanë aplikuar.

iii Niveli I ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Përcaktimi i marrëveshjes së bashkëpunimit për dërgimin e listave të fëmijëve në moshë kopshti mes:
 1. Bashkisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,
 2. Bashkisë dhe Qendrave Shëndetësore.

Marrëveshja do të përmbajë karakteristikat e listës që nevojitet (emri i fëmijëve, ditëlindja, vendbanimi), afatet e përgatitjes dhe dërgimit të saj, zyra/personi përgjegjës i secilit institucion për mbulimin e detyrimeve sipas marrëveshjes dhe mënyrën e dërgimit të listave.

B: Menaxheriale

1. Përcaktimi i një personi/zyre përgjegjëse nga secili institucion për dërgimin/marrjen e listave sipas rregullave të marrëveshjes së firmosur.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Kryerja e takimeve mes aktorëve për theksimin e nevojës për identifikimin e fëmijëve në moshë kopshti; propozimin për bashkëpunim dhe identifikimi i problematikave (nëse ka) në realizimin e bashkëpunimit dhe gjetja e zgjidhjeve. Do të kryhen 2 takime:
 1. Takim me përfaqësues të Bashkisë dhe Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit , Gjendjes Civile në bashkinë Vau Dejës dhe përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
 2. Takim me përfaqësues të Qendrave Shëndetësore dhe Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit ;
2. Hartimi dhe firmosja e marrëveshjes mes Bashkisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Bashkisë dhe Qendrave Shëndetësore;
3. Zbatimi i marrëveshjes. Marrja e listave nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe hartimi i një liste të unifikuar të fëmijëve në moshë kopshti.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Listë vjetore të fëmijëve në moshë kopshti;
2. Lehtësim i procesit të regjistrimit të fëmijëve sipas zonave të banimit;
3. Rritja e normës së regjistrimit të fëmijëve në kopsht;
4. Mundësia e uljes së grupeve të përziera dhe numrit të fëmijëve në këto grupe.

5. Mundësia e projekcionit të regjistrimit të fëmijëve në plan 3-vjeçar.

<p>Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë) Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit</p>	<p>Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Gjendja Civile e Bashkisë Vau Dejës • Qendrat Shëndetësore në Bashkinë e Vau Dejës
--	--

e) **Shpenzimet e llogaritura** (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026
1	Kryerja e takimeve	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	10,000	10,000	10,000
2	Hartimi dhe firmosja e marrëveshjes	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
3	Zbatimi i marrëveshjes	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

f) **Periudha e zbatimit:**
2024

g) **Ndjek zbatimin e projektit:**
Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Nr. 002	Projekti: Krijimi i platformës digjitale e cila përmban të	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin
---------	---	---

	dhëna analitike për kopshtin	parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>Gjatë punës për diagnostikimin dhe përgatitjen e raporteve analitike të situatës të Arsimit Parashkollor në Bashkinë Vau Dejës u vu re një mosrakordim i të dhënave mes ZVAP, Bashkisë, Njësive Administrative dhe Kopshteve.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Mosrakordimi i të dhënave mes Bashkisë, ZVAP, Njësive Administrative dhe Kopshteve u vu re në të dhëna si numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte, numri i mësuesve, numri i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale (me disavantazh social), kapaciteti akomodues i kopshteve, etj. Mosrakordimi i të dhënave vështirëson diagnostikimin e situatës, evidentimin e problemeve dhe shkaqeve të tyre dhe evidentimin e nevojës për ndërhyrje ose ndryshime në kopshte.</p> <p>Duke mos pasur një databazë të unifikuar të të dhënave mes këtyre dy institucioneve, nuk është e qartë nëse duhet të mbyllet disa kopshte meqë janë nën kapacitet dhe fëmijët të transferohen në kopshte të tjera të afërta, apo të ndërtohen kopshte të reja për të ulur mbipopullimin. Problematika reale është e vështirë të identifikohet menjëherë dhe si pasojë edhe zgjidhjet për të do të vonohen të zbatohen.</p> <p>Është e nevojshme të krijohet një sistem i unifikuar i të dhënave në kohë reale, në mënyrë që të dhënat të jenë të sakta, të gjithë aktorët të kenë akses te këto të dhëna dhe ndryshimi i tyre të jetë i menjëhershëm, pa kosto dhe njëkohësisht të të gjitha databazat e aktorëve. Në këtë mënyrë, Sektori i Arsimit Parashkollor dhe ZVAP do të mund të bëjnë parashikimet dhe planifikimet e nevojshme për ofrimin e një shërbimi efikas.</p>		
ii Synimi i projektit		
<p>Një mënyrë për të pasur një unifikim të të dhënave në kohë reale është krijimi i një Platforme Digjitale e cila përmban të dhëna analitike për kopshtin.</p> <p>Në këtë platformë mund të kenë akses:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit mund të ketë akses te të gjitha të dhënat për çdo kopsht dhe është përgjegjëse për plotësimin e tyre. • Drejtorja e Zhvillimit të Territorit dhe Kontrollit të Shërbimeve mund të ketë akses në seksionin e gjendjes fizike të ndërtesave të kopshteve, për të plotësuar të dhënat për çdo kopsht, pas vlerësimit të kryer çdo vit. • Njësia e Shërbimeve Sociale për të plotësuar të dhënat për fëmijët në nevojë për mbrojtje, në nevojë për përfshirje sociale dhe me aftësi të kufizuar. <p>Nëpërmjet këtij projekti synohet rakordimi i të dhënave dhe koordinimi mes Bashkisë, Njësive Administrative, ZVAP dhe kopshteve dhe lehtësimi i procesit të vlerësimit të nevojave që ka çdo kopsht. Në këtë mënyrë do të bëhet e mundur që situata e arsimit parashkollor të jetë e qartë.</p>		

Struktura e Platformës do të përmbajë:

1. **Seksionin e të dhënave të përgjithshme** (emri i kopshtit, njësia administrative, adresa, nëse kopshti është publik ose privat, me ushqim ose pa ushqim, në godinë më vete ose jo, emri dhe kontaktet e drejtuesit, etj.)
2. **Seksioni i të dhënave të fëmijëve** (numri i fëmijëve të regjistruar sipas moshës, gjinisë dhe grupit ku bëjnë pjesë, numri i grupeve sipas llojeve, numri i fëmijëve në çdo grup, frekuentimi çdo muaj, etj.)
3. **Seksioni i të dhënave mbi organizmat që funksionojnë brenda kopshtit** (Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit dhe Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit).
4. **Seksioni i të dhënave të inventarit të kopshtit** (numri i mobilieve, viti i blerjes, gjendja e tyre, materialet didaktike dhe kancelarike, etj.)
5. **Seksioni i Shërbimeve Sociale** (numri i fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale dhe aftësi të kufizuar sipas vendbanimit/kopshtit, moshës, gjinisë, etj.)
6. **Seksioni i gjendjes fizike të godinës së kopshtit** (nevojat për mirëmbajtje dhe rikonstrukcion sipas prioritetit të ndërhyrjes, furnizimi me ujë, elektricitet, internet dhe ngrohje, numri i hapësirave, sipërfaqja e secilës prej hapësirave, etj.)
7. **Seksioni i Burimeve Njerëzore** (numri i mësueseve, mësueseve ndihmëse, stafit mbështetës, përvoja në punë, mosha dhe gjinia, etj.)

Nëpërmjet platformës mund të gjenerohen edhe analizat e situatës nga të dhënat e plotësuar. Për shembull, mund të llogaritet kapaciteti akomodues i kopshteve (duke marrë si referencë hapësirat në m² të kopshteve, numrin e klasave, etj.). Gjithashtu, mund të llogaritet numri i fëmijëve për një mësuese, norma e frekuentimit, norma e regjistrimit të fëmijëve, numri i karrigeve për 1 tavolinë, numri i shtretërve, numri i fëmijëve që flenë në kopsht dhe kërkesa për mobilje të reja në secilin prej kopshteve. Kështu, Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit do të ketë të qartë situatën e kopshteve dhe nevojës për ndërhyrje.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Hartimi i një rregullore për mënyrën e plotësimit të Platformës Digjitale, institucionet që kanë akses, afatet e plotësimit ose të dërgimit të të dhënave te Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit , etj.
2. Hartimi i një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë dhe ZVAP mbi raportimin e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte për të shmangur raportimin direkt të kopshteve pranë ZVAP dhe si rrjedhim mosrakordimin e shifrave.

B: Menaxheriale

1. Blerja e Platformës Digjitale për hedhjen e të dhënave individuale të kopshteve dhe gjenerimin e analizave. Bashkia mund të nënkontrakttojë një operator ekonomik për krijimin dhe mirëmbajtjen e Platformës Digjitale nëpërmjet procedurave të Prokurimit

Publik.

2. Dërgimi i informacioneve të detajuara drejt Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit nga kopshtet sipas procedurave të përcaktuara në rregullore.
3. Plotësimi i të dhënave nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit , Njësia e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Kontrollit të Shërbimeve.
4. Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Kontrollit të Shërbimeve kryen vlerësimin e ndërtesave të kopshteve çdo vit nëpërmjet vizitave në terren. Vlerësimi fillon në muajin Mars të çdo viti dhe përfundon në muajin Prill. Të dhënat e mbledhura nga inspektimet hidhen në Platformën Digjitale brenda muajit Maj.
5. Gjenerimi i analizave të situatës së kopshteve dhe planifikimi i ndërhyrjes në nivel kopshti nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit .
6. Dërgimi i të dhënave të ZVAP dhe Njësitë Administrative.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Blerja dhe mirëmbajtja e Platformës Digjitale
2. Trajnimi i punonjësve që do të hedhin të dhëna ose do të gjenerojnë analiza. Pas blerjes së platformës, do të trajnohet stafi i cili do të jetë përgjegjës për përdorimin e Platformës.
3. Njohja e punonjësve me detyrimet e tyre në respektimin e afateve të plotësimit të të dhënave dhe gjenerimit të analizave. Stafi i kopshteve, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit , Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtorisë së Shërbimit Social njihet me rregulloren.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Platforma Digjitale me të dhënat individuale të kopshteve të plotësuara në kohë reale
2. Analiza e Situatës së kopshteve dhe planifikimi i ndërhyrjeve
3. Zgjidhja e problemeve në kohë reale

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
- Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Kontrollit të Shërbimeve
- Njësia e Prokurimit Publik

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- ZVAP;
- Njësitë Administrative.

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026
1	Blerja dhe mirëmbajtje e Platformës Digjitale	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	100,000	100,000	100,000
2	Trajnime i punonjësve që do të hedhin të dhëna ose do të gjenerojnë analiza	Operatori Ekonomik/Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
3	Njohja e punonjësve me detyrimet e tyre në respektimin e afateve të plotësimit të të dhënave dhe gjenerimit të analizave	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
f) Periudha e zbatimit: 2024		g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

Nr. 003	Projekti: Regjistrimi në kopsht sipas banimit	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Regjistrimi i fëmijëve bëhet sipas hartës së vendbanimit por ka dhe rste specifike kur kjo nuk ndodh, kjo për arsye të ndryshme që mund të lidhen me punësimin e prindërve afër këtyre kopshteve etj... Prindërit zgjedhin ti regjistrojnë fëmijët e tyre pranë kopshteve ku ata punojnë ose pranë shtëpive të gjyshërve.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Momentalisht, në kopshtet e qytetit ka fëmijë të cilët nuk i përkasin kopshtit ku janë regjistruar bazuar në zonën e tyre të banimit. Për momentin, ky fakt nuk shkakton një problematikë të madhe, duke qenë se numri i regjistrimeve është i ulët dhe kopshtet janë brenda kapaciteteve të tyre. Megjithatë, me rritjen e numrit të regjistrimeve në kopshte, parashikohet të ndodhë njësoj si në bashkitë e tjera që janë marrë në studim: Kopshtet e qendrës të jenë mbi kapacitetin e tyre akomodues dhe kopshtet e periferisë të jenë nën kapacitetin e tyre. Për këtë arsye, është e nevojshme të ndërhyet për të parandaluar këtë fenomen, duke siguruar		

regjistrimin e fëmijëve në kopshte sipas zonës së tyre të banimit.

ii Synimi i projektit

Ky projekt përqendrohet në realizimin e regjistrimit të fëmijëve në kopsht sipas zonës së banimit nëpërmjet përcaktimit të një rregulloreje, e cila do të ndiqet nga të gjitha kopshtet.

iii Niveli I ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Urdhër nga Kryetari i Bashkisë për regjistrimin e fëmijëve në kopshtet pranë zonës së tyre të banimit;
2. Hartimi i një rregulloreje që përcakton procedurën, aktorët përgjegjës, afatet kohore dhe mënyrën e ndërveprimit ndërmjet palëve gjatë procesit të regjistrimit të fëmijëve në kopshte nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit ;
3. Hartimi i një kontrate tip mes prindërve dhe kopshteve, e cila do të përfshijë rregulloren e kopshtit si edhe do të sanksionojë të drejtat dhe detyrimet e palëve gjatë veprimtarisë së kopshtit. Kjo do të rregullonte planifikimin e shërbimit nga kopshtet.

B: Menaxheriale

Një model i rregullores mund të jetë si më poshtë:

1. Prindërit përpos dokumentave që dorëzojnë për regjistrimin e fëmijëve në kopsht, duhet të dorëzojnë dhe Certifikatën e vendbanimit. Afati i dorëzimit të dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e fëmijëve është 1 - 10 qershor;
2. Kopshti merr dokumentet e dorëzuara nga prindërit për çdo fëmijë dhe ia dërgon Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit . Dokumentet për çdo fëmijë mund të dërgohen nga kopshti deri në 2 ditë pas mbylljes së afatit të aplikimit;
3. Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit merr vendimin bazuar në dokumentet e secilit prej fëmijëve dhe listën që disponon me fëmijët në moshë kopshti dhe i dërgon kopshteve listën e fëmijëve të regjistruar dhe listën e fëmijëve që nuk u është pranuar aplikimi së bashku me arsyet. Afati për marrjen e vendimit është deri në fund të qershorit. Gjithashtu, identifikon nëpërmjet listës së fëmijëve në moshë kopshti, fëmijët që nuk janë regjistruar ende në kopsht;
4. Në rastin kur një aplikim për regjistrim refuzohet, prindërit njoftohen nga drejtuesi i kopshtit mbi arsyet pse është refuzuar aplikimi dhe i sugjeron kopshtin në të cilin fëmijës i takon të regjistrohet;
5. Pasi regjistrimet përfundojnë, sipas udhëzimeve të Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit , drejtuesit/mësuesit e kopshteve mund të takojnë prindërit të cilët nuk kanë regjistruar ende fëmijët, për të identifikuar arsyet e mos regjistrimit dhe informuar prindërit mbi rëndësinë e arsimit parashkollor të fëmija. Kjo detyrë mund t'i përcaktohet dhe një punonjësi tjetër, si përshebull grupeve të terrenit që kanë si detyrë identifikimin e fëmijëve në situatë rruge.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Nxjerrja e Urdhërit nga Kryetari i Bashkisë për regjistrimin sipas zonës së banimit;
2. Hartimi i rregullores mbi procedurën e regjistrimit;
3. Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit;
4. Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht;
5. Takime me prindërit për regjistrimin e fëmijëve.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)					
<ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së banimit; 2. Shpërndarje e njejtë e regjistrimit të fëmijëve; 3. Rritje e numrit të regjistrimeve. 					
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)		
<ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit • Kryetari i Bashkisë 					
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)					
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026
1	Nxjerrja e Urdhërit nga Kryetari i Bashkisë për regjistrimin sipas zonës së banimit	Kryetari i Bashkisë			
2	Hartimi i rregullores mbi procedurat e regjistrimit	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
3	Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimit	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
4	Identifikimi i fëmijëve që nuk janë regjistruar në kopsht	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
5	Takimi me prindërit për regjistrimin e fëmijëve	Drejtues/mësues i kopshtit			
f) Periudha e zbatimit: 2024			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit		

Nr. 004	Projekti: Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo Kopsht	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
<p>i Situata</p> <p>Kopshtet në Bashkinë Vau Dejës nuk hartojnë dhe zbatojnë një plan afatmesëm.</p> <p>Plani Afatmesëm përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Misionin; • Vizionin; • Analiza e gjendjes; • Përparësitë; • Veprimtaritë kryesore për realizimin e përparësive; • Produkti ose treguesit e arritjeve; • Buxheti i përafërt. <p>Duke mos hartuar një plan afatmesëm, kopshtet nuk kanë një analizë të qartë të situatës, objektiva dhe një plan aktivitetesh për të arritur objektivat.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Në Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 “<i>Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë</i>” përcaktohet kompetenca e hartimit të Planit Afatmesëm të IA dhe rubrikat e tij. Sipas tij, detyrën për ngritjen e grupit të punës nga mësues dhe persona që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore (me kryetar drejtuesin e kopshtit) për hartimin e planit afatmesëm e ka drejtuesi i kopshtit.</p>		
ii Synimi i projektit		
<p>Nëpërmjet këtij projekti synohet rritja e kapaciteteve në lidhje me hartimin e planit afatmesëm dhe hartimi i planit në gjithë kopshtet e Bashkisë Vau Dejës.</p>		
<p>iii Niveli I ndërhyrjes</p> <p>A: Ligjore</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nxjerrja e një Urdhri nga Kryetari i Bashkisë ku përcakton se kompetencat për monitorimin e hartimit dhe zbatimit të planit afatmesëm e ka Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe drejtuesit e kopshteve duhet të raportojnë te ZVAP dhe Bashkia. <p>B: Menaxheriale</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zbatimi i Urdhrit nr. 31, neni 49 dhe 50 për hartimin dhe zbatimin e planit afatmesëm 		

në të gjitha kopshtet e Bashkisë së Vau Dejës.					
iv Aktivitetet kryesore të projektit					
1. Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo kopsht.					
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)					
1. Kopshtet vendosin vetë objektiva dhe arrijnë ato; 2. Kopshtet funksionojnë jo vetëm si institucione në varësi të Bashkisë, por kanë edhe plane dhe objektiva të vetat që nxisin zhvillimin më të shpejtë të tyre.					
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)		
<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit 					
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)					
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026
1	Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo kopsht	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	1,500		
f) Periudha e zbatimit: 2025-2026			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit		

Nr. 005	Projekti: Vlerësimi i brendshëm i kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Aktualisht, nuk ekziston një metodë e unifikuar për vlerësimin e brendshëm të kopshteve të Bashkisë Vau Dejës. Vlerësimi i brendshëm ka si synim të analizojë pikat e forta, mundësitë për përmirësime dhe faktorët që kanë favorizuar ose penguar cilësinë.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Sipas Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 <i>“Për miratimin e rregullores për funksionimin e</i>		

institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, vlerësimi i brendshëm:

1. përfshin të gjithë punonjësit arsimorë të institucionit, psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin;
2. kryhet çdo vit;
3. mbulon të gjitha fushat që përfshin monitorimi dhe vlerësimi i IA-së;
4. vlerësimi i brendshëm kryhet në nivel individual (drejtori, mësuesi, psikologu) dhe në nivel organizmesh.

ii Synimi i projektit

Vlerësimi i brendshëm i kopshteve ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga ana e tij, nëpërmjet analizës dhe reflektimit për arritjet dhe mundësitë për përmirësim. Ky projekt ka si synim hartimin e një metode të unifikuar për të gjithë kopshtet për të kryer çdo vit vlerësimin e brendshëm. Gjithashtu është shumë e rëndësishme të përcaktohen fushat mbi të cilat realizohet vlerësimi i brendshëm. Përvoja ka treguar që duhet që vlerësimi i brendshëm të ketë të njëjtat fusha mbi të cilat realizohet vlerësimi i jashtëm i kopshtit.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Nxjerrja e një udhëzuesi metodologjik për vlerësimin e brendshëm të kopshtit. ASCAP ka hartuar tashmë udhëzuesin metodologjik për vlerësimin e brendshëm të shkollës;
2. Nxjerrja e Urdhrit nga Kryetarët e bashkisë, për realizimin e vlerësimit të brendshëm nga drejtuesit e kopshtit.

B: Menaxheriale

3. Bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit të Brendshëm (Urdhër nr. 54, datë 26.05.2020 “Për miratimin e paketës së vlerësimit të cilësisë së shkollës”) Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit harton pyetësorë për mësuesit, prindërit dhe drejtorët e kopshteve/përgjegjësit e kopshteve për të kryer vlerësimin e brendshëm;
4. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve/përgjegjësve të kopshteve për vlerësimin e brendshëm bazuar mbi Metodologjinë e Vlerësimit të Brendshëm të Shkollës;
5. Drejtuesit e kopshteve/Përgjegjësit e kopshteve trainojnë stafin arsimor të kopshtit dhe organizmat e kopshtit (Këshillin, Bordin dhe Komisionin) për kryerjen e vlerësimit të brendshëm;
6. Drejtuesi i kopshtit/përgjegjësi i kopshtit organizon një fokus grup me personat me përgjegjësi prindërore, mësuesit dhe anëtarë të tjerë të organizmave të kopshtit për të diskutuar për një numër të vogël temash ose aspektesh që lidhen me kopshtin. Fokus grupi zhvillohet në periudhën kohore të pranuar nga të gjithë anëtarët dhe ka 6-8 pjesëmarrës;
7. Koordinator i grupit, me ndihmën e koordinаторit të ZVAP, harton analizën përmbledhëse të vlerësimit të brendshëm.
8. Rezultatet mund të përdoren për hartimin e planit afatmesëm të kopshteve ose planeve

vjetore.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i pyetësorëve për prindër, mësues dhe drejtues të kopshteve nga ASCAP;
2. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve mbi metodën e vlerësimit të brendshëm nga ASCAP;
3. Trajnimi i stafit arsimor të kopshteve dhe organizmave të kopshtit mbi metodën e vlerësimit të brendshëm nga drejtuesit e kopshteve;
4. Organizimi i fokus grupeve;
5. Analiza dhe raportimi i rezultateve.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Kryerja çdo vit e vlerësimit të brendshëm të kopshteve nëpërmjet pyetësorëve dhe fokus grupeve duke krijuar disa indikatorë të matshëm;
2. Nxitja për vet-përmirësim i mësuesve, drejtuesve dhe organizmave të kopshteve;
3. Planifikimi më objektiv bazuar në rezultatet e vlerësimit të brendshëm.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- ASCAP;
- ZVAP.

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Përgjegjes	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026
1	Hartimi i pyetësorëve	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
2	Trajnimi i stafit arsimor dhe organizmave të kopshtit	Drejtuesi/përgjegjësi i kopshtit	70,000	70,000	
3	Organizimi i fokus grupeve dhe	Drejtuesi/përgjegjësi i kopshtit			

	plotësimi i pyetësorëve				
4	Analiza dhe raportimi i rezultateve	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
f) Periudha e zbatimit: 2024			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit		

Nr. 006	Projekti: Punësimi i një specialisti pranë Sektorit të Arsimit vetëm për arsimin parashkollor	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Bashkia Vau Dejës planifikon që në vitin 2024 të punësojë një specialist për arsimin parashkollor i cili të jetë përgjegjës vetëm për menaxhimin e arsimit parashkollor.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Në Bashkinë Vau Dejës operojnë 20 kopshte publike ku sektori i Arsimit në bashkëpunim me mësueset e kopshteve menaxhon shërbimin e kopshteve dhe merret me detyra si:		
<ul style="list-style-type: none"> • Ndjek regjistrimet e fillim vitit; • Ndjek ngritjen dhe funksionimin e bordit të kopshtit, këshillit të prindërve, dhe komisionit të shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit; • Ndjek punën e mësuesve; • Përgatit informacionin për inspektimet e kryera sipas platformave të inspektimit; • Ndjek ecurinë e kopshtit; • Merr raportimet mbi nevojat e kopshteve ose çështje të tjera në lidhje me kopshtin dhe i adreson në institucionin e duhur. 		
Përgjegjësitë e mësipërme së bashku me detyrat të tjera që lidhen Arsimin Parauniversitar mund të shkaktojnë ezaurim të stafit dhe mungesë në efikasitetin e kryerjes së përgjegjësive për shkak të mungesës së stafit. Për këtë arsye është e nevojshme punësimi i një specialisti vetëm për arsimin parashkollor.		
ii Synimi i projektit		
Ky projekt synon punësimin e një specialisti për arsimin pranë Sektorit të Arsimit.		
iii Niveli I ndërhyrjes		

A: Ligjore

1. Miratimi në KB i buxhetit për pagën e punonjësit të ri;
2. Firmosja e kontratës së punës mes Bashkisë Vau Dejës dhe Specialistit për arsimin parashkollor.

B: Menaxheriale

1. Drejtorja e Burimeve Njerëzore shpall vendin e lirë të punës në web-in e Bashkisë Vau Dejës.
2. Përzgjedhja e specialistit të arsimit parashkollor që do të punojë pranë Sektorit të Arsimit;
3. Prezantimi i punonjësit të ri me stafin me të cilin do të bashkëpunojë, detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Miratimi në KB së buxhetit për pagën e një specialisti për arsimin;
2. Shpallja në web e vendit të lirë të punës;
3. Përzgjedhja e specialistit dhe firmosja e kontratës. Paga e specialistit mund të jetë 59 mijë lekë (përfshirë taksat dhe kontributet që do të paguhen nga punëdhënësi dhe punëmarrësi).

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Menaxhim më efikas i shërbimit të arsimit parashkollor.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtorja e Burimeve Njerëzore
- Sektori i Arsimit

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti 2021	Buxheti 2022	Buxheti 2023
1	Miratimi në KB së buxhetit për pagën e një specialisti për arsimin	Sektori i Arsimit			

2	Shpallja në web e vendit të lirë të punës	Drejtoria e Burimeve Njerëzore			
3	Përzgjedhja e specialistit dhe firmosja e kontratës	Drejtoria Juridike, Prokurimeve, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	732,000	732,000	732,000
f) Periudha e zbatimit: 2024-2025			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Burimeve Njerëzore		

2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor

2.4.1 Këshilli i Prindërve

Informacion i përgjithshëm

Nga 20 kopshte që janë intervistuar, pyetjes mbi themelimin e Këshillit, rezulton se të 12 kopshte kanë themeluar Këshillin e Prindërve, 6 kopshte nuk e kanë themeluar ndërsa 2 kopshte nuk janë përgjigjur. Në Bashkinë Vau Dejës, numri minimal i anëtarëve të Këshillit të Prindërve është 3, numri mesatar i anëtarëve është 4 dhe numri maksimal është 8 anëtarë.

Në bashkinë Vau Dejës këshilli i prindërve zhvillon mbledhje 2 here ne vit. Mbledhje të tjera zhvillohen ose me nismën e kryetarit të Këshillit ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij.

Objektiva kryesore:

Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht sipas Udhëzimit Nr. 31 dhe rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve përsa i përket të drejtave dhe detyrimeve të tij

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Themelimi i Këshillit të Prindërve në të gjithë Kopshtet sipas Udhëzimit Nr. 31 dhe ndarja e tij nga Këshilli i Shkollës
2	Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve në menaxhimin e kopshtit

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
016	Numri i mbledhjeve të	Qender	Vlere	Mesatare	2	2	2	2

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
	Këshillit të Prindërve							
013	Numri i anëtarëve në Këshillin e Prindërve	Qender	Vlere	Mesatare	4	5	6	6
012	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve	Qender	Vlere	Mesatare	0	1	1	1
011	Numri i kopshteve që kanë themeluar Këshillin e Prindërve	Qender	Vlere	Shumatore	12	20	20	20

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Buxhet Vit 1	Buxhet Vit 2	Buxhet Vit 3
008	Fuqizimi i Këshillit të Prindërve	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	0	0	0
007	Themelimi i Këshillit të Prindërve	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	80,000	0	0

Lista e projekteve

Nr. 007	Projekti: Themelimi i Këshillit të Prindërve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Nga 20 kopshte që janë intervistuar, pyetjes mbi themelimin e Këshillit, rezulton se 12 kopshte kanë themeluar Këshillin e Prindërve, 6 kopshte nuk e kanë themeluar ndërsa 2 kopshte nuk janë përgjigjur.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Në Bashkinë Vau Dejës 15 kopshte gjenden në godinat e shkollave. Këto kopshte menaxhohen nga drejtorët e shkollave por edhe mësueset. Përveç ambienteve të përbashkëta me nxënësit e shkollës, në këto kopshte funksionojnë organizmat e ngritura për shkollat. Mënyra se si themelohet Këshilli i Prindërve dhe si funksionon në vazhdim nuk është e qartë.		
ii Synimi i projektit		
Nëpërmjet këtij projekti synohet:		
<ol style="list-style-type: none">1. Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht dhe ndarja e tij nga Këshilli i Shkollës;2. Rritja e pjesëmarrjes së prindërve në Këshillat e Prindërve. Sipas Udhëzimit nr. 31, Këshilli mund të ketë 6-9 anëtarë. Jo të gjitha kopshtet e përmbushin këtë kriter. Bashkia nëpërmjet monitorimit të saj gjatë themelimit do të sigurojë përmbushjen e këtij standardi (bëjnë përjashtim kopshtet të cilat kanë më pak se 10 fëmijë të regjistruar).		
iii Niveli I ndërhyrjes		
A: Menaxheriale		
<ol style="list-style-type: none">1. Kopshtet themelojnë Këshillin e Prindërve dhe i dërgojnë listën e anëtarëve Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit sipas Udhëzimit nr. 31;2. Kopshtet që ndodhen në godinat e Shkollave themelojnë Këshillin e Prindërve të mëvetësishëm nga Këshilli i Prindërve të Shkollës;3. Drejtorja e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit monitoron procesin e themelimit të Këshillave të Prindërve për të siguruar që çdo kopsht i përmbahet Udhëzimit nr. 31 dhe monitoron mbarëvajtjen e Këshillit të Prindërve përgjatë vitit.		
iv Aktivitetet kryesore të projektit		
<ol style="list-style-type: none">1. Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht;2. Monitorimi i procesit të themelimit të Këshillit të Prindërve.		

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)					
1. Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht sipas Udhëzimit nr. 31.					
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)		
<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit 					
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)					
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026
1	Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht	Drejtuuesi/Përgjegjësi i kopshtit			
2	Monitorimi i procesit të themelimit të Këshillit të Prindërve	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
f) Periudha e zbatimit: 2024			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit		

Nr. 008	Projekti: Fuqizimi i Këshillit të Prindërve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>Jo të gjitha kopshtet kanë numrin minimal të anëtarëve në Bordin e Prindërve, të parashikuar sipas legjisllacionit në fuqi (Neni 89/pika 4: Këshilli i Prindërve të institucionit përbëhet nga 6-9 prindër të zgjedhur nga këshillat e klasave). Në kopshtet e NJA Bushat dhe Vau Dejës numri i anëtarëve të këshillit të prindërve është 6. Ndërsa në Njësitë e tjera administrative si Hajmel, Vig Mnelë dhe Temal numri mesatar i anëtarëve të këshillit të prindërve është 3</p> <p>Ndërkohë, mungon informacion mbi përqindjen e numrit të prindërve që marrin pjesë në</p>		

takime, për të kuptuar sa i rëndësishëm është mbledhja e këtij Këshilli për të sjellë ndryshime në kopsht.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Duke qenë se Këshilli i Prindërve përbën një prej aktorëve kryesorë të interesuar për një shërbim sa më të mirë të arsimit parashkollor dhe nëse funksionon vetëm formalisht, atëherë është e vështirë që shumë probleme të kopshteve, që kërkojnë edhe buxhet të madh, të jenë prioritet për Këshillin Bashkiak ose Bashkinë.

ii Synimi i projektit

Nëpërmjet këtij projekti synohet:

1. Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve. Në organizimin e aktiviteteve do të kërkohet përfshirja e anëtarëve të Këshillit të Prindërve dhe në këtë mënyrë do të rritet angazhimi i tyre në kopsht.

Për të fuqizuar Këshillin e Prindërve shihet tejet i nevojshëm dhe primar detajimi i Urdhrit Nr. 31, në të cilin duhet të vendosen edhe format e raportimit të Këshillit dhe rruga që ndiqet për t'i dhënë zgjidhje problemeve që mund të ngrihen nga Këshilli.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Hartimi i një protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve (Bashki, NJA, ZVAP), rreth mënyrës së raportimit të Këshillit dhe rrugës që Këshilli ndjek për t'i dhënë zgjidhje problemeve të ngritura në mbledhje. Detajimi nëpërmjet një udhëzimi të posaçëm siç është udhëzimi nr. 25 për Bordin e Kopshtit, që edhe këshilli për çështje të cilat kanë nevojë për zgjidhje nga bashkia, të raportojë pranë bashkisë.

B: Menaxheriale

1. Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit organizon një trajnim në fillim të vitit për drejtuesit e kopshteve/mësuesit përgjegjës mbi të drejtat dhe detyrat e Këshillit të Prindërve. Ky trajnim do të organizohet së bashku me trajnimin për Bordin e Kopshtit kështu që nuk do të ketë kosto shtesë;
2. Drejtuesit e kopshteve organizojnë një takim me anëtarët e Këshillit të Prindërve për t'i trainuar mbi të drejtat dhe detyrat e tyre;
3. Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit ndjek dhe asiston drejtuesit e kopshteve në trajnimet që ata kryejnë me Këshillin e Prindërve.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve (Bashki, NJA, ZVAP), rreth mënyrës së raportimit të këshillit dhe rrugës që Këshilli ndjek për t'i dhënë zgjidhje problemeve të ngritura në mbledhje;
2. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve/mësuesve përgjegjës nga Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit ;

3. Trajnimi i anëtarëve të Këshillit të Prindërve nga drejtuesit e kopshteve/mësuesit përgjegjës.					
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)					
1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve dhe drejtuesve; 2. Protokoll i unifikuar mbi mënyrën se si themelohet Këshilli i Prindërve, si raportohen çështjet që diskutohen gjatë mbledhjeve dhe si marrin zgjidhje.					
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)		
<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit 			<ul style="list-style-type: none"> OJF 		
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)					
Nr	Emertimi	Përgjegjes	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026
1	Hartimi i protokollit të unifikuar ndërmjet institucioneve	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
2	Trajnimi i anëtarëve të Këshillit të Prindërve	Drejtuesit e kopshteve/mësuesit përgjegjës	80,000		
			80,000		
f) Periudha e zbatimit: 2024			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit		

2.4.2 Bordin i Kopshtit

Informacion i përgjithshëm

Në kopshtet publike të Bashkisë Vau Dejës, vihet re se një pjesë e kopshteve nuk e kanë themeluar Bordin e kopshtit, por edhe kopshtet të cilat ndodhen brenda shkollave funksionon Bordin i ngritur për Shkollën edhe për kopshtet. Përkatësisht 10 kopshte kanë të themeluar Bordin e kopshtit nga 20 kopshte në total.

Ndërkohë sipas Udhëzimit Nr. 25, bordi përbëhet nga 7 anëtarët, ndërkohë në kopshtet publike të Bashkisë Vau Dejës, numri minimal i anëtarëve të Bordit të Kopshteve është 3 në NJA Hajmel, ndërsa numri maksimal i anëtarëve të Bordit të Kopshtit është 6 anëtarë në kopshtin Don Martin Trushi dhe Imzot Luçjan Avgustini në Njësitë Administrative Vau Dejës dhe Bushat.

Bordi duhet të mbledhet jo më pak se tri herë në vit, në bashkinë Vau Dejës një pjesë e kopshteve i përmbahen këtij standarti. Kopshti Lush Kola në NJA Bushat, kopshti Lulet e Jetës dhe Aneksi Paçram në NJA Hajmel zhvillojnë vetëm nga 1 mbledhje.

Objektiva kryesore:

Themelimi dhe fuqizimi i Bordit të Kopshtit si organizëm që siguron mbarëvajtjen e arsimit parashkollor dhe adreson çështjet problematike për zgjidhjen e tyre.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopsht
2	Rritja e aktivizimit të Bordit të Kopshtit në adresimin e problematikave të kopshtit
3	Adresimi i çështjeve të diskutuara në organizmat e kopshteve në Bashki

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
024	Numri i mbledhjeve të Bordit të Kopshtit	Fshat	Vlere	Mesatare	2	3	3	3
024	Numri i mbledhjeve të Bordit të Kopshtit	Qender	Vlere	Mesatare	3	3	3	3
023	Numri i	Fshat	Vlere	Mesatare	0	1	1	1

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
	trajtimeve të anëtarëve të Bordit të Kopshtit							
023	Numri i trajtimeve të anëtarëve të Bordit të Kopshtit	Qender	Vlere	Mesatare	0	1	1	1
022	Mbledhje të KB mbi arsimin parashkollor ku ka marrë pjesë Grupi Përfaqësues ndaj mbledhjeve totale mbi arsimin parashkollor	Bashki	Vlere	Shumatore	0	2	3	4
021	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Bordi i Kopshtit	Fshat	Vlere	Mesatare	0	3	4	5
021	Numri i problemeve të zgjidhura ndaj problemeve të ngritura nga Bordi i Kopshtit	Qender	Vlere	Mesatare	0	3	4	5
020	Numri i anëtarëve në Bordin e Kopshtit	Fshat	Vlere	Mesatare	4	5	6	6
020	Numri i anëtarëve në Bordin e Kopshtit	Qender	Vlere	Mesatare	4	5	6	6
019	Numri i kopshteve që kanë Bordin e Kopshtit të	Qender	Vlere	Shumatore				

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
	përbashkët me Bordin e Shkollës							
018	Numri i kopshteve që kanë themeluar Bordin e Kopshtit	Qender	Vlere	Shumatore	10	20	20	20

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Buxhet Vit 1	Buxhet Vit 2	Buxhet Vit 3
011	Ngritja e një strukture lidhëse mes Bashkisë dhe kopshteve	Drejtorja e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
010	Fuqizimi i Bordit të Kopshtit	Drejtorja e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	80,000		
009	Themelimi i Bordit të Kopshtit	Drejtorja e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

Lista e projekteve

Nr. 009	Projekti: Themelimi i Bordit të Kopshtit	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Vetëm në 10 kopshte është themeluar Bordi i Kopshtit, përse u përket kopshteve të cilat ndodhen brenda ambjentit të shkollave, funksionon Bordin e shkollës në të cilën ndodhet Kopshti.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Bordi i Kopshtit ka si synim të sigurojë që shërbimi arsimor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit nëpërmjet njohjes së problemeve, zgjidhjes ose adresimit për zgjidhjen e tyre. Bordin kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor në përputhje me aktet ligjore në fuqi.		

Megjithatë, jo të gjitha kopshtet e kanë themeluar Bordin e Kopshtit. Gjithashtu, nuk shpjegohet qartë se cila është procedura që ndiqet nga Bordi, për zgjidhjen e problemeve që ngrihen në të.

Disa kopshte e kanë Bordin e tyre të integruar me Bordin e Shkollës. Në këtë rast, për shkak të vëmendjes më të madhe që i kushtohet arsimit bazë, dhe për faktin që numri i nxënësve, mësuesve dhe si pasojë edhe i çështjeve që duhen trajtuar është më i madh në arsimin bazë, problemet e kopshteve mund të lihen në hije. Në këto kopshte Bashkia nuk ka asnjë informacion nëse Bordi është themeluar ose jo, fakt ky që thekson rolin formal që ka Bordi.

ii Synimi i projektit

Është e nevojshme të ndërhyet për të themeluar Bordin e Kopshtit në kopshtet që ende nuk e kanë themeluar dhe të ndahet Bordi i Kopshtit nga ai i shkollave. Duke qenë se në NJA numri i fëmijëve të regjistruar është i vogël dhe kjo sjell vështirësi në themelimin e Bordit në secilin kopsht, është e nevojshme që të ngrihen kapacitetet e Bordit të Kopshtit në nivel Njësie Administrative.

Nëpërmjet këtij projekti synohet:

1. Themelimi i Bordit në të gjitha kopshtet sipas Udhëzimit nr. 25
2. Ndarja e Bordit të Kopshtit nga ai i Shkollave.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Krijimi i një vendimi të posaçëm nga Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit për ngritjen dhe funksionimin e Bordit në kopshte ku nuk ka drejtor, ku përcaktohet si person përgjegjës për këto detyra (të përcaktuara në Udhëzimin nr. 25, *“Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të Institucionit Arsimor”*) drejtuesi i 5 grupeve (në rastet kur do të zbatohet Udhëzimi nr. 30 për vendosjen e një drejtuesi për 5 grupe) ose mësuesi përgjegjës (në mungesë të drejtuesit të kopshtit).

B: Menaxheriale

1. Pas regjistrimit të fëmijëve dhe fillimit të procesit mësimor të kopshteve, Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit , njofton nëpërmjet një shkrese zyrtare me e-mail drejtuesit/mësuesit përgjegjës për themelimin e Bordit të Kopshtit brenda një afati 10 ditor.
2. Themelimi i Bordit të Kopshtit në kopshte dhe dërgimi i organogramës së Bordit në Bashki.
 - Drejtuesi i kopshtit njofton Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
3. sa herë që Bordi i Kopshtit mblidhet dhe çështjet që diskuton duke i dërguar procesverbalët ose dokumente të tjera shtesë të mbajtura nga Sekretari i Bordit.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopsht

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Krijimi i Bordit dhe funksioni i plotë i tij në çdo kopsht;
2. Rritja e monitorimit të Bordit të Kopshtit nga ana e Bashkisë.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
- Kryetari i Bashkisë

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026
1	Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopsht	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

f) Periudha e zbatimit:
2024

g) Ndjek zbatimin e projektit:
Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Nr. 010

Projekti: Fuqizimi i Bordit të Kopshtit

Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor
Funksioni: 09

a) Përshkrim i shkurtër i projektit

i Situata

Jo të gjitha kopshtet kanë numrin minimal të anëtarëve në Bordin e institucionit Arsimor. Gjatë analizës vihet re qartë, që në disa kopshte Bordi nuk është krijuar por funksionon bordi i shkollës.

Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje

Bordi i Kopshtit ka si synim të sigurojë që shërbimi arsimor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e lokale dhe interesave të komunitetit nëpërmjet njohjes së problemeve, zgjidhjes ose adresimit për zgjidhjen e tyre. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Megjithatë, jo të gjitha kopshtet kanë numrin minimal të anëtarëve në Bord dhe në disa kopshte Bordi nuk është krijuar por funksionon bordi i shkollës pra synimi i tij nuk realizohet praktikisht.

ii Synimi i projektit

Nëpërmjet këtij projekti synohet:

1. Fuqizimi i Bordit të Kopshtit si organizëm që siguron mbarëvajtjen e arsimit parashkollor dhe adreson çështjet problematike për zgjidhjen e tyre.

iii Niveli I ndërhyrjes

A: Menaxheriale

1. Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit organizon një trajnim në fillim të vitit për drejtuesit e kopshteve/mësuesit përgjegjës mbi të drejtat dhe detyrat e Bordit të Kopshtit;
2. Drejtuesit e kopshteve/mësueset përgjegjëse organizojnë një takim me anëtarët e Bordit për t'i trainuar mbi të drejtat dhe detyrat e tyre;
3. Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit ndjek dhe asiston drejtuesit e kopshteve/mësueset përgjegjëse në trajnimet që ata kryejnë me Bordin e Kopshtit.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve/mësuesve përgjegjës nga Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Kostot e trajnimit mund të jenë 1.5 mijë lekë/person.
2. Trajnimi i anëtarëve të Bordit të Kopshtit nga drejtuesit e kopshteve/mësueset përgjegjëse.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Bordit të Kopshteve dhe drejtuesve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026
1	Trajnimi i anëtarëve të Bordit të Kopshtit	Drejtuesit e kopshteve/mësueset përgjegjëse	80,000		
			80,000		
f) Periudha e zbatimit: 2024			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit		

Nr. 011	Projekti: Ngritja e një strukture lidhëse mes Bashkisë dhe kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Edhe pse në një pjesë të kopshteve në Bashkinë Vau Dejës e kanë ngritur Këshillin e Prindërve, Bordin e Kopshtit dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, nuk është e qartë se si temat që diskutojnë dhe problematikat që evidentojnë adresohen në Bashki për të gjetur zgjidhje.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Në një pjesë të kopshteve duket sikur organizmat e mësipërm funksionojnë vetëm formalisht. Kjo do të thotë se nevojat e kopshteve të evidentuara në takime nuk adresohen në Bashki dhe nuk diskutohen në Këshillin e Bashkisë për të gjetur zgjidhje. Për këtë arsye është e nevojshme të ndërtohet një urë komunikimi mes këtyre organizmave dhe Bashkisë.		
ii Synimi i projektit		
Për anëtarët e Këshillit, Bordit dhe Komisionit të kopshteve pranë NJA, mund të jetë e vështirë pjesëmarrja në takimet e Këshillit të Bashkisë kur diskutohet buxheti apo planifikohen investimet. Duke munguar një zë në këto takime që thekson problematikat e kopshteve, shihet e vështirë gjetja e zgjidhjeve të tyre.		
Ndaj, nëpërmjet këtij projekti synohet që të krijohet një grup përfaqësues me pjesëmarrës nga Këshillat e Prindërve, Bordeve të Kopshteve dhe Komisioneve nga të gjitha kopshtet e Bashkisë, që do të ketë kontakte me të gjitha organizmat në gjithë kopshtet dhe do të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak sa herë diskutohen ëështje që lidhen me arsimin parashkollor. Në këtë mënyrë synohet që të ngrihet zëri mbi problematikat e kopshteve dhe të gjenden zgjidhje për to.		

iii Niveli I ndërhyrjes**A: Ligjore**

1. Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit krijon një rregullore mbi të drejtat dhe detyrat e Grupit Përfaqësues, mënyrën e raportimit, mënyrën e njoftimit për mbledhje, etj.

B: Menaxheriale

1. Sapo në të gjitha kopshtet janë themeluar Këshilli, Bordi dhe Komisioni, krijohet Grupi Përfaqësues. Grupi Përfaqësues nuk ka minimum dhe maksimum anëtarësh. Anëtarët mund të jenë nga ëdo kopsht apo organizëm dhe pjesëmarrja në të është vullnetare;
2. Kur ky grup formohet, drejtuesit e kopshteve (të trainuar tashmë nga Bashkia) informojnë anëtarët mbi të drejtat, detyrimet dhe protokollin e adresimit të një çështjeje.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i rregullores për ngritjen e Grupit Përfaqësues;
2. Krijimi i Grupit Përfaqësues;
3. Informimi i anëtarëve të Grupit nga drejtuesit e kopshteve mbi të drejtat dhe detyrimet.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Ngritja e një grupi përfaqësues i 3 organizmave të kopshteve, që do të përfaqësojë kopshtet në nivelin vendor;
2. Theksimi më i madh i problematikave të kopshteve në Bashki.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026
1	Hartimi i rregullores për ngritjen e Grupit Përfaqësues	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
2	Krijimi i Grupit Përfaqësues	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

		/Drejtuesit e kopshteve			
3	Informimi i anëtarëve të Grupit mbi të drejtat dhe detyrimet	Drejtuesit e kopshteve			
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit		

2.4.3 Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit

Informacion i përgjithshëm

Në kopshtet e Bashkisë Vau Dejës, **8 Kopshte** e kanë themeluar Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, ndërsa **10 Kopshte** nuk e kanë themeluar, dhe 2 kopshte nuk kanë dhënë përgjigje mbi themelimin e Komisionit.

Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit ka në përbërje të tij edhe prindër të caktuar nga këshilli i prindërve.

Referuar të dhënave të mbledhura, në të gjitha kopshtet që e kanë themeluar Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, rezulton se nuk kemi një informacion të qarte se sa prindër pjesë e këtij të fundit janë dhe anëtarë nga Këshilli i Prindërve,

Ndërkohë përse i takon mbledhjeve të komisionit për ti dhënë zgjidhje problematikave të krijuara në kopësht ai duhet të mblihet për të diskutuar problemet. Sipas analizës së të dhënave komisioni është mbledhur mesatarisht 3 herë në vit.

Objektiva kryesore:

Themelimi dhe fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit sipas Udhëzimit nr. 31.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Themelimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në çdo kopsht dhe ndarja e Komisionit të Kopshtit nga ai i Shkollës
2	Fuqizimi i Komisionit për të marrë pjesë në identifikimin e nevojave dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve të krijuara në kopshte

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
------	------------	-------------------------	-----------	----------	-------------	-----------	-----------	-----------

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
030	Kopshte që kanë hartuar rregulloren e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit	Qender	Vlere	Shumatore	0	10	5	5
028	Numri i anëtarëve në Komisionin e Shëndetit	Qender	Vlere	Mesatare				
027	Numri i trajnimeve të anëtarëve të Komisionit të Shëndetit	Qender	Vlere	Mesatare	3	5	5	5
026	Kopshtet që e kanë Komisionin e Shëndetit të integruar në Komisionin e Shkollës	Qender	Vlere	Shumatore				
025	Kopshtet që kanë themeluar Komisionin e Shëndetit	Qender	Vlere	Shumatore	8	20	20	20

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Buxhet Vit 1	Buxhet Vit 2	Buxhet Vit 3
013	Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	80,000		
012	Ngritja i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

Lista e projekteve

Nr. 012	Projekti: Ngritja i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Një pjesë e kopshteve nuk e kanë ngritur akoma Komisionin siç është e përcaktuar në urdhrin Nr. 31, datë 28.01.2020. Gjithashtu, një pjesë e madhe e këtyre kopshteve ndodhen brenda shkollave, dhe zakonisht ky Komision funksionon edhe për kopshtin.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Disa prej detyrave kryesore të Komisionit (<i>sipas Urdhërit nr. 31 "Miratimin e rregullores, për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë"</i>) janë: a) mbikëqyr rregullisht në institucionin arsimor kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve dhe ruajtjen e mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve; b) identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit; c) përcakton nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve; ç) organizon veprimtari ndërgjegjësuere me nxënës, mësues dhe prindër për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve e pajisjeve të institucionit.</p> <p>Detyrat e mësipërme janë shumë të rëndësishme dhe mungesa e Komisionit ose funksionimi vetëm formal i tij bën që këto detyra të mos mbulojnë fare ose të mbulojnë pjesërisht. Gjithashtu, për kopshtet brenda godinave të shkollave ku Komisioni është i integruar me Komisionin e Shkollës shkakton të njëjtën problematikë.</p>		
ii Synimi i projektit		
<ol style="list-style-type: none">1. Themelimi i Komisionit në çdo kopsht;2. Ndarja e Komisionit të Kopshtit nga ai i Shkollës;3. Informimi i Bashkisë rreth problemeve dhe tematikave, të cilat diskutohet në Komision, por që është e nevojshme ndërhyrja e Bashkisë për t'i dhënë zgjidhje.		
iii Niveli I ndërhyrjes		
A: Ligjore		
<ol style="list-style-type: none">1. Krijimi i një vendimi të posaçëm për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Shëndetit në nivel NJA2. Nxjerrja e një Urdhri nga Kryetari i Bashkisë ku kompetencën për themelimin dhe monitorimin e Komisionit të Shëndetit e ka Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit,		

Rinisë dhe Sportit pranë Bashkisë.

B: Menaxheriale

1. Pas regjistrimit të fëmijëve dhe fillimit të procesit mësimor të kopshteve, Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit , njofton nëpërmjet një shkrese zyrtare me e-mail drejtuesit/mësuesit përgjegjës për themelimin e Komisionit të Shëndetit brenda një afati 10 ditor.
2. Themelimi i Komisionit të Shëndetit në kopshte dhe dërgimi i organogramës së Komisionit në Bashki.
3. Drejtuesi i kopshtit/mësuesi përgjegjës plotëson në Platformën Digjitale/njofton Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit sa herë që Komisioni mbledhet dhe çështjet që diskuton.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Themelimi i Komisionit të Shëndetit çdo vit në çdo kopsht

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Krijimi i Komisionit dhe funksioni i plotë i tij në çdo kopsht

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026
1	Themelimi i Komisionit të Shëndetit	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

f) Periudha e zbatimit:
2024-2026

g) Ndjek zbatimin e projektit:
Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Nr. 013	Projekti: Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata Komisioni i Shëndetit mesatarisht është mbledhur mesatarisht 3 herë në vit në të gjitha kopshtet e Bashkisë Vau Dejës. Por ka edhe kopshte tek të cilat komisioni është mbledhur vetëm 1 herë në vit, kopshti Lulet e Jetës në NJA Hajmel.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Disa prej detyrave kryesore të Komisionit (sipas Urdhërit nr. 31, datë 28.01.2020 „ <i>Miratimin e rregullores, për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë</i> “) janë: a) mbikëqyr rregullisht në institucionin arsimor kushtet e ruajtjes së shëndetit, të higjienës, pastërtisë, mjedisit, të sigurisë së nxënësve dhe punonjësve dhe ruajtjen e mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve; b) identifikon nevojat për mirëmbajtje të institucionit; c) përcakton nevojat për ndreqje të vogla, shërbime, zëvendësime të pjesëve për shkak të dëmtimeve; ç) organizon veprimtari ndërgjegjësuere me nxënës, mësues dhe prindër për kushtet e ruajtjes së shëndetit, të sigurisë, mirëmbajtjes së mjediseve e pajisjeve të institucionit. Detyrat e mësipërme janë shumë të rëndësishme dhe funksionimi vetëm formal i tij bën që këto detyra të mos mbulohen fare ose të mbulohen pjesërisht.		
ii Synimi i projektit		
1. Fuqizimi i Komisionit për të marrë pjesë në identifikimin e nevojave dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve të krijuara në kopshte.		
iii Niveli I ndërhyrjes		
A: Menaxheriale		
1. Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit organizon një trajnim për drejtuesit e kopshtit për të drejtat dhe detyrimet e Komisionit, mënyrën e adresimit të problemeve, etj. 2. Drejtuesit e Kopshteve organizojnë takime informuese me anëtarët e Komisionit për të drejtat, detyrimet e tyre dhe mënyrën e adresimit të problemeve.		
iv Aktivitetet kryesore të projektit		
1. Trajnimi i drejtuesve të kopshteve nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit ;		

2. Trajnimi i anëtarëve të Komisionit nga drejtuesit e kopshteve.					
b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)					
1. Ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të Komisionit dhe drejtuesve të kopshteve.					
Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)			Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)		
<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit 			<ul style="list-style-type: none"> OJF 		
e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)					
Nr	Emertimi	Përgjegjes	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026
1	Trajnimi i anëtarëve të Komisionit	Drejtuesi/Përgjegjësi i kopshtit	80,000		
			80,000		
f) Periudha e zbatimit: 2024-2026			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit		

3. Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

3.1 Qëllimi

Proceset kryesore janë ato procese që i shërbejnë drejtpërdrejt përmbushjes së objektivave strategjike ose qëllimit të institucionit. Këto procese ofrojnë një pjesë të konsiderueshme të performancës së një institucioni dhe konsumojnë një pjesë të konsiderueshme të burimeve. Në lidhje me kopshtet publike, fëmijët regjistrohen dhe mbërrijnë në objekt (këtu fillon procesi) dhe largohen pasi të kenë marrë arsimin parashkollor (procesi përfundon).

Plani i përmirësimit të shërbimit ka si qëllim rritjen e identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit më të mirë të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, fëmijë etj), fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe fëmijët me aftësi të kufizuar.

3.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivat kryesore të planeve të përmirësimit në lidhje me Proceset Kryesore janë:

1. Përmirësimi i procesit të identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuar;
2. Përmirësimi i infrastrukturës me qëllim aksesimin e kopshteve nga fëmijët me aftësi të kufizuar.

3.3 Fëmijët me aftësi të kufizuar

Në kopshtet publike të Bashkisë Vau Dejës ka 15 fëmijë me aftësi të kufizuar që frekuentojnë kopshtin. Bashkia ka vetëm një mesues mbeshtetes për fëmijët me aftësi të kufizuar.

Një pjesë e kopshteve në Bashkisë Vau Dejës kanë nevojë për vendosjen e rampave në mënyrë që fëmijët me AK të aksesojnë kopshtin.

3.3.1 Kërkesa për fonde shtesë

Informacion i përgjithshëm

Infrastruktura e kopshteve nuk është e përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në ndërtesat e kopshteve mungojnë rampat. Edhe pse mund të jetë gjetur një zgjidhje provizore, është e nevojshme që në kopshte të vendosen rampat, në përputhje me standardin për infrastrukturën e kopshteve.

Objektiva kryesore:

Plotësimi i standardeve të aksesueshmërisë të fëmijëve me AK në arsimin parashkollor

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Heqja e barrierave që pengojnë aksesueshmërinë e fëmijëve me AK në kopshte
2	Përmirësimi i komunikimit mësues-prind gjatë diagnostikimit të fëmijës
3	Ofrimi shërbimit psikosocial në kopshte

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
055	Kopshte që kanë rampa (%)	Qender	%	Tjeter	2	6	6	6
049	Numri i fëmijëve me AK në total	Qender	Vlere	Shumatore	15	15		
048	Fëmijë me AK që janë diagnostikuar pas dyshimit të stafit të kopshtit (%)	Qender	%	Tjeter				
047	Numri i fëmijëve me AK të diagnostikuar këtë vit	Qender	Vlere	Shumatore				
	Numri i mësuesve ndihmes	Bashki	Vlere	Shumatore	1	6	7	7

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026
015	Vendosja e rampave dhe respektimi i standardeve për infrastrukturën e fëmijëve me AK pranë institucioneve	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe	200,000	200,000	200,000

Numri	Projekti	Pergjegjes	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026
	arsimore	Sportit			
014	Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me AK përmes mbështetjes psikosociale të prindërve dhe mësuesve	Sektori i Ndhimes Ekonomike dhe PAK			
16	Ofrimi i shërbimit psikosocial për fëmijët me AK pranë kopshteve	Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse			

Lista e projekteve

Nr. 015	Projekti: Vendosja e rampave dhe respektimi i standardeve për infrastrukturën e fëmijëve me AK pranë institucioneve arsimore	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>Infrastruktura e kopshteve nuk është e përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në ndërtesat e kopshteve mungojnë rampat. Edhe pse mund të jetë gjetur një zgjidhje provizore, është e nevojshme që në kopshte të vendosen rampat, në përputhje me standardin për infrastrukturën e kopshteve.</p> <p>Kopshti “Gjon Ndoci” është godina më vete në të cilat mungon rampa. Kopshte të tjerë të cilët kanë nevojë për vendosjen e rampave janë; kopshti Koman, Pistull, kopshti Don Martin Trushi, kopshti Kosmaq etj..</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Ndërkohë që numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar është i paqartë, gjithsesi infrastruktura e kopshteve nuk është e përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuar. Në ndërtesat e kopshteve mungojnë rampat. Edhe pse mund të jetë gjetur një zgjidhje provizore, është e nevojshme që në kopshte të vendosen rampat, në përputhje me standardin për infrastrukturën e kopshteve.</p>		
ii Synimi i projektit		

Synimi i këtij projekti është pajisja e gjithë ndërtesave të kopshteve me rampa për të lehtësuar aksesueshmërinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopsht.

Në VKM nr. 1074, datë 23.12.2015, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, përcaktohen masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohe pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

iii Niveli i ndërhyrjes

A: Ligjore

1. Miratimi në KB i buxhetit për vendosjen e rampave dhe në kopshte;
2. Firmosja e kontratës mes Bashkisë dhe Operatorit/ëve ekonomik.

B: Menaxheriale

1. Hartimi i planit të ndërhyrjes për vendosjen e rampave në kopshte nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Plani do të përmbajë shtrirjen kohore të ndërhyrjes, kopshtet që do të vendosen rampa çdo vit dhe kostot;
2. Hapja e procedurës së prokurimit publik për gjetjen e operatorit ekonomik për vendosjen e rampave.

C: Infrastrukturore

1. Vendosja e rampave në kopshte nga operatori ekonomik.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i planit të ndërhyrjes për vendosjen e rampave në kopshte nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit
2. Miratimi në KB i buxhetit për vendosjen e rampave në kopshte;
3. Hapja e procedurës së prokurimit publik dhe gjetja e operatorit ekonomik për vendosjen e rampave;
4. Vendosja e rampave në kopshte nga operatori ekonomik.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

Të gjithë kopshtet kanë rampa në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të aksesojnë lehtësisht kopshtin.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Ndihmës Ekonomike,

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF

<p>Arsimit, Rinisë dhe Sportit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, • Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. 	<ul style="list-style-type: none"> • Operator/ët ekonomik 				
<p>e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)</p>					
Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026
1	Hartimi i planit	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
2	Miratimi në KB i buxhetit	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
3	Hapja e procedurës së prokurimit publik dhe gjetja e operatorit ekonomik	Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Shërbimet Mbështetëse			
4	Vendosja e rampave në kopshte nga operatori ekonomik	Operatori/ët ekonomik	200,000	200,000	200,000
			200,000	200,000	200,000
<p>f) Periudha e zbatimit: 2024-2026</p>			<p>g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit</p>		

Lista e projekteve

<p>Nr. 014</p>	<p>Projekti: Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me AK përmes mbështetjes psiko-sociale të prindërve dhe mësuesve</p>	<p>Programi Buxhetor: 10140 - Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara</p> <p>Funksioni: 10</p>
<p>a)Përshkrim i shkurtër i projektit</p>		
<p>i Situata</p> <p>Në Bashkinë Vau Dejës nuk ka të identifikuar fëmijë me AK të cilët frekuentojnë kopshtin. Mësuesit e kopshteve hasin probleme me prindërit në momentin që ata dyshojnë se fëmija mund të jetë me aftësi të kufizuara. Prindërit nuk pranojnë të vizitojnë fëmijën e tyre sepse refuzojnë të pranojnë se mund të jetë me aftësi të kufizuara mendore ose fizike.</p>		
<p>Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje</p>		
<p>Qëndresa që bëjnë prindërit kur dyshohet se fëmijët e tyre mund të jenë me aftësi të kufizuara vonon procesin e diagnostikimit të fëmijëve dhe trajtimin e tyre sa më parë. Për këtë arsye duhet ndërhyrë nga Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Shërbimi Psiko-Social për të punuar me këtë problem.</p>		
<p>ii Synimi i projektit</p> <p>Ky projekt synon rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve për rëndësinë e diagnostikimit të hershëm dhe trajtimin e specializuar të fëmijës me aftësi të kufizuara dhe asistimin e mësuesve gjatë procesit të komunikimit me prindërit.</p>		
<p>iii Niveli i ndërhyrjes</p> <p>A: Ligjore</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i buxhetit për trajnimet e mësuesve në KB <p>B: Menaxheriale</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hartimi i planit të trajnimit të mësuesve të arsimit parashkollor mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind nga psikologët e Njesisë së Arsimit Parashkollor. Trajnimet mund të organizohen në nivel Njësie Administrative për mësuesit që punojnë në kopshtet që ndodhen në zonat rurale dhe në nivel rajoni për mësuesit e kopshteve që ndodhen në qytetin e Vau Dejës. 2. Trajnimet e organizuara në qytet nuk kanë kosto, ndërsa ato të organizuara në Njësitë Administrative kanë kostot e transportit; 3. Organizimi i trajnimeve për mësuesit e arsimit parashkollor nga psikologët e Njesisë së Arsimit Parashkollor mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind; 4. Mësuesi njofton Njësinë e Arsimit Parashkollor në rast se has një problem me prindërit përse i përket diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara; 5. Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit vë në dispozicion një 		

psikolog për të trajtuar problematikën e raportuar, duke komunikuar me prindërit dhe mësuesin.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i planit të trajnimeve për mësuesit;
2. Miratimi i planit të trajnimeve në KB;
3. Organizim i trajnimeve për mësuesit mbi mënyrat e komunikimit mësues-prind;
4. Ofrimi i shërbimit psiko-social për prindërit që kanë vështirësi për të pranuar se fëmijët e tyre mund të jenë me aftësi të kufizuara.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Përshpejtim i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit;
- Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF;

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026
1	Hartimi i planit të trajnimit të mësuesve	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
2	Miratimi i planit të trajnimit të mësuesve në KB	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
3	Organizim i trajnimeve për mësuesit	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	150,000		

f) Periudha e zbatimit:

g) Ndjek zbatimin e projektit:

Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Nr. 016	Projekti: Ofrimi i shërbimit psikosocial për fëmijët me AK pranë kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
<p>i Situata</p> <p>Bashkia Vau Dejës planifikon që në vitin 2024 të punësojë 5 mësues ndihmës për arsimin parashkollor, për tju përgjigjur numrit 15 të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Aktualisht ka vetëm 1 (një) mësues ndihmës që ndjek dhe punon me një fëmijë me aftësi të kufizuara ndërkohë që nuk ka për 14 fëmijë të tjerë.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Kompetenca e menaxhimit të kopshteve dhe punësimit të mësuesve ndihmës i ka kaluar pushtetit vendor, megjithatë Bashkisë së Vau Dejës në transfertat e kushtëzuara për paga dhe kontribute nuk i vjen asnjë fond për mësues ndihmës.</p> <p>Ndërkohë, në Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 2: ZVA përcakton mësues ndihmës për fëmijët me AK bazuar në diagnozën e Komisionit Multidisiplinor.</p> <p>Bashkia do të vlerësojë në bashkëpunim ZVAP Shkoder numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara për vitin 2024-2025 dhe në vijim dhe do të dërgojë një kërkesë për fonde shtesë Ministrisë së Financave për mësues ndihmës. Në rast se kjo kërkesë nuk merr përgjigje pozitive Bashkia do të vlerësojë ofrimin e këtij shërbimi me fondet e veta.</p>		
ii Synimi i projektit		
<p>Ky projekt ka si synim hartimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi mes ZVAP dhe Bashkisë në lidhje me menaxhimin e rasteve të fëmijëve me AK, duke qenë se ZVAP merr pjesë në procesin e diagnostikimit dhe trajtimit të fëmijëve me AK. Në marrëveshje do të përcaktohen qartë kompetencat, të drejtat dhe detyrat e Bashkisë dhe ZVAP në lidhje me diagnostikimin dhe trajtimin e fëmijëve me AK</p> <p>Ky projekt synon punësimin e mësuesve ndihmës për Arsimin parashkollor pranë Sektorit të Arsimit.</p>		
iii Niveli I ndërhyrjes		
<p>A: Ligjore</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Takimi mes ZVAP dhe Bashkisë dhe hartimi i një marrëveshjeje që përcakton kompetencat e secilit bazuar në aktet ligjore në lidhje me trajtimin e rasteve të fëmijëve me AK. 		

2. Vleresimi i nevojës për numrin e mësuesve ndihmës nga Sektori i Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Buxhetit dhe ZVAP Shkoder.
3. Përcaktimi i numrit të mësuesve ndihmës që do punësohen në bashkëpunim me Njësinë e Buxhetit.
4. Pergatitja e kërkeses për fonde për tju drejtuar Ministrisë së Financave
5. Propozimi pranë KB për punësimin e mësuesve ndihmës të dedikuar për fëmijët e arsimit parashkollor dhe miratimi nga KB i buxhetit për punësimin e psikologëve.

B: Menaxheriale

1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore shpall vendin e lirë të punës në web-in e Bashkisë Vau Dejës.
2. Përzgjedhja e mësuesve ndihmës të arsimit parashkollor që do të punojë pranë Sektorit të Arsimit;
3. Prezantimi i mësuesve ndihmës të ri me stafin me të cilin do të bashkëpunojë, detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Vleresimi i nevojës për numrin e mësuesve ndihmës nga Sektori i Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë e Buxhetit dhe ZVAP Shkodër
2. Miratimi në KB së buxhetit për pagën e një mësuesi ndihmës për arsimin;
3. Shpallja në web e vendit të lirë të punës;
4. Përzgjedhja e mësuesve ndihmës dhe firmosja e kontratave. Paga e një mësuesi ndihmës do të jetë 59 mijë lekë (përfshirë taksat dhe kontributet që do të paguheshin nga punëdhënësi dhe punëmarrësi).

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

2. Menaxhim më efikas i shërbimit të arsimit parashkollor.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore
- Sektori i Arsimit

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm)

Nr	Emertimi	Përgjegjes	Fakt Aktual	Buxheti 2021	Buxheti 2022	Buxheti 2023
1	Vleresimi dhe përcaktimi i numrit	Sektori i Arsimit,				

	të mësuesve ndihmës që do punësohen	Burimet Njerezore dhe Buxheti				
2	Miratimi në KB së buxhetit për pagën e mësuesve ndihmës për arsimin parashkollor	Sektori i Arsimit				
3	Shpallja në web e vendit të lirë të punës	Drejtoria e Burimeve Njerezore				
4	Përzgjedhja e mësuesve ndihmës dhe firmosja e kontratës	Drejtoria Burimeve Njerezore	708,000	4,248,000	4,248,000	4,248,000
f) Periudha e zbatimit: 2024-2025			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Burimeve Njerezore			

Risqet

Risku	Mitigimi
Mungesa e fondeve për të financuar këtë projekt rrezikon realizimin e tij	Përpjekja për të gjetur donatorë

4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

4.1 Qëllimi

Proceset mbështetëse janë procese që ofrojnë mbështetje për proceset kryesore. Proceset mbështetëse duhet të gjenden brenda ose jashtë institucionit. Në shembullin e kopshtit, një proces mbështetës mund të jetë shtimi i burimeve njerëzore pranë Bashkisë, për të koordinuar në aktivitetet e planit të përmirësimit të arsimit parashkollor.

Planet e përmirësimit të shërbimit kanë si qëllim ofrimin e shërbimit sa më efikas të kopshteve në aspektin e edukimit të fëmijëve, sigurisë së tyre, zhvillimit të tyre dhe sigurimin e aksesueshmërisë së shërbimit nga të gjithë. Plani fokusohet në trajnimin e stafit të kopshteve, përmirësimin e godinave të kopshteve dhe rritjen e aksesueshmërisë dhe arritjes së kopshtit nga të gjithë fëmijët.

4.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivi kryesor i planeve të përmirësimit të shërbimit në lidhje me Proceset Mbështetëse është arritja e standardeve të vendosura nga aktet ligjore përsa i përket numrit të stafit të kopshteve, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave, llojet e materialeve didaktike dhe sigurimin e aksesit në kopsht.

4.3 Burimet Njerëzore

4.3.1 Rekrutimi i stafit

Informacion i përgjithshëm

Në kopshtet publike të Bashkisë Vau Dejës janë të punësuar 36 mësues, mesatarisht 1 mësuese për 7 fëmijë në zonat rurale dhe 1 mësuese për 16 fëmijë në zonat urbane.

Gjithashtu në këtë bashki mbetet i vështirë, menaxhimi i burimeve njerëzore veçanërisht në kopshtet në të cilat nuk kemi drejtues kopshti, si dhe i kopshteve që ndodhen brenda godinave të shkollave. Nga 20 kopshte publike në total, vetëm 5 prej tyre janë në godinë më vete, ndërsa pjesa tjetër 15 kopshte janë akomoduar brenda godinave të shkollave.

Objektiva kryesore:

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të kopshteve duke siguruar nivelin e duhur të stafit përcaktuar nga aktet ligjore.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Aplikimi i Udhëzimit Nr.14, sipas të cilit kemi një drejtor për 5 grupe nxënësish në kopsht

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
080	Raporti i qendrueshmërisë së mësuesve	Qender	%	Mesatare				
078	Numri i fëmijëve për një mësuese	Qender	Vlere	Mesatare	16	16	16	16
078	Numri i fëmijëve për një mësuese	Fshat	Vlere	Mesatare	7	10	10	10
057	Kopshte që menaxhohen nga drejtues të shkollave	Qender	Vlere	Shumatore	20	5	0	0
057	Kopshte që menaxhohen nga drejtues të shkollave	Fshat	Vlere	Shumatore	15	5	0	0
056	Numri i drejtuesve të kopshteve	Qender	Vlere	Shumatore	0	1	2	2

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Buxhet Vit 1	Buxhet Vit 2	Buxhet Vit 3
017	Zbatimi i Udhëzimit Nr. 14 për punësimin e drejtorëve për kopshtet për 5 grupe fëmijësh	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Sportit dhe Rinisë	666,000	666,000	666,000

Lista e projekteve

Nr. 017	Projekti: Zbatimi i Udhëzimit Nr. 14 për punësimin e drejtorëve për	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin
---------	--	---

	kopshtet për 5 grupe fëmijësh	parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
<p>i Situata</p> <p>Nga 20 kopshte publike në total, vetëm 5 prej tyre janë në godinë më vete, ndërsa pjesa tjetër 15 kopshte janë akomoduar brenda godinave të shkollave.</p> <p>Ekzistenca e kopshteve brenda godinave të shkollave, shpesh krijon problematika në mirëfunksionimin e kopshteve si institucione më vete, vështirësi në menaxhimin e godinës, çështjeve infrastrukturore, bordi i kopshtit dhe këshilli i prindërve nuk funksionojnë më vete, por përzihen me komisionet e shkollës.</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
<p>Drejtuesit e kopshteve kanë shumë detyrë të rëndësishme në menaxhimin e kopshtit dhe është e pamundur që një mësuese t'i kryejë ato, sidomos duke marrë parasysh faktin se mësuesja ka përgjegjësi të tjera.</p> <p>Për këtë arsye, është e nevojshme që kopshtet të kenë drejtuesit e tyre duke u bazuar në Udhëzimin Nr. 14, ku vendoset 1 drejtues kopshti për 5 grupe.</p>		
<p>ii Synimi i projektit</p> <p>Duke vendosur një drejtues për 5 grupe fëmijësh në kopshte, i cili raporton në Drejtorinë e Arsimit dhe ka si detyrë të vetme menaxhimin e kopshteve, synohet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Menaxhimi më efikas i kopshteve; 2. Nevojat dhe problemet e kopshteve adresohen në kohën e duhur dhe institucionin e duhur, duke marrë zgjidhje më shpejt; 3. Lehtësimi i procesit të edukimit, sepse mësueset do të fokusohen vetëm në edukimin dhe menaxhimin e klasës së tyre. 		
<p>iii Niveli i ndërhyrjes</p> <p>A: Ligjore</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i buxhetit për punësimin e drejtuesve të kopshteve sipas Udhëzimit nr. 14; 2. Nxjerrja e një Urdhëri nga Kryetari i Bashkisë për zbatimin e Udhëzimit nr. 14/2023 dhe udhëzime specifike në rastin kur për shkak të infrastrukturës apo transportit nuk mund të realizohet udhëzimi 1 drejtues për 5 grupe. <p>B: Menaxheriale</p>		

1. Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit harton planin për punësimin e drejtuesve të rinj: sa drejtues duhen dhe cilët kopshte do të menaxhojnë;
2. Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit i paraqet KB planin dhe buxhetin për miratim;
3. Pas miratimit të planit dhe buxhetit nga KB dhe nxjerrjes së Urdhërit nga Kryetari i Bashkisë për punësimin e Drejtuesve fillon procedura e punësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i planit dhe buxhetit të punësimit të drejtuesve (sa drejtues, për cilat kopshte dhe kur do punësohen);
2. Propozimi dhe miratimi në KB;
3. Punësimi i drejtuesve të rinj në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. Paga e 1 drejtuesi kopshti pa ushqim është 55.5 mijë lekë.
4. Ri-organizimi i përgjegjësive dhe kopshteve nën menaxhim të drejtuesve të kopshteve.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Menaxhimi efikas i kopshteve;
2. Zgjidhja më e shpejtë e problemeve që mund të ketë çdo kopsht;
3. Procesi i nxënies së fëmijëve më efikas.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- OJF

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Përgjegjes	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026
1	Hartimi i planit dhe buxhetit të punësimit të drejtuesve	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

2	Propozimi dhe miratimi në KB	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
3	Punësimi i drejtuesve të rinj	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit /Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	666,000	666,000	666,000
4	Ri-organizimi i përgjegjësive dhe kopshteve nën menaxhim të drejtuesve të kopshteve	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	0		
f) Periudha e zbatimit: 2024			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit		

4.4 Menaxhimi i godinave

4.4.1 Rikonstruksioni i objekteve

Informacion i përgjithshëm

Gjatë analizës së situatës së arsimit parashkollor në Bashkinë Vau Dejës u evidentua se një pjesë e kopshteve kanë nevojë për rikonstruksion. Disa nga problemet më shqetësuese kishin të bënin me rikonstruksionin e brendshëm dhe lysterja e godinave. Një pjesë e madhe e kopshteve kanë nevojë për rikonstruksion të tualeteve pasi janë të vjetra dhe jo të pershtatshme për fëmijët.

Më shumë se gjysma e kopshteve publike në territorin e Bashkisë Vau Dejës ndodhen brenda godinave të shkollave. Po behet rikonstruksion i plotë i shkollës Mjedë dhe gjithashtu kopshti Hajmel është në proces restaurimi. Kopshtet e tjera janë restauruar më parë.

Sistemi i ngrohjes në kopshte është me dru, vetëm në tre kopshte brenda shkollave ka sistem me kalidaje. Sistemi hidraulik ka vetëm probleme në zonat e thella. Duhet parë mundësia e vendosjes së depozitave në kopshtet ku mungon uji i rrjedhshëm

Objektiva kryesore:

Rikonstruksioni i godinave duke iu përmbajtur standardeve për hapësirat e kopshteve dhe facilitetet e nevojshme.

Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Rikonstruksioni i godinave të kopshteve të cilat kanë nevojë për rikonstruksion
2	Ofrimi i ujit të rrjedhshëm në kopshtet ku mungon

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
075	Numri i kopshteve që ofrojnë ujë të pijshëm	Fshat	Vlere	Shumatore				
074	Numri i godinave që janë rikonstruktuar	Qender	Vlere	Shumatore				
073	Numri i godinave që kanë nevojë për rikonstruksion	Qender	Vlere	Shumatore				

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Buxhet Vit 1	Buxhet Vit 2	Buxhet Vit 3
018	Rikonstruksion i banjove te kopshteve (20 banjo)	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit	500,000	300,000	300,000
019	Krijimi i kendeve te lojrave per femije ne kopshte	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit	800.000	800.000	800.000

Numri	Projekti	Pergjegjes	Buxhet Vit 1	Buxhet Vit 2	Buxhet Vit 3
20	Hapja e Kopshtit me dreke	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit/ Drejtoria e Arsimit	3,900,000	4,300,000	800,000
			5,200,000	5,400,000	1,900,000

Lista e projekteve

Nr. 018	Projekti: Rikonstruksion i banjove te kopshteve	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Nga analiza e situatës së arsimit parashkollor në Bashkinë Vau Dejës rezultoi se në një pjesë e kopshteve banjot kanë nevojë për rikonstruksion.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Sipas “Standarde për Projektimin e Kopshteve”, miratuar me Urdhërin nr. 159, datë 01.03.2017 në kopshte, kapitulli 5 Si të organizohet hapësira e kopshtit - Shërbimet higjienike dhe kapitulli 10.4 Impianti i furnizimit me ujë të ftohtë hidro/sanitar (H/S).		
ii Synimi i projektit		
Sipas “Standarde për Projektimin e Kopshteve”, miratuar me Urdhërin nr. 159, datë 01.03.2017 Shërbimet higjienike (sip.min. 15m ²) (dimensionimi minimal i referohet numrit minimal të fëmijëve)		
iii Niveli i ndërhyrjes		
A: Ligjore		
1. Miratimi në KB i buxhetit për rikonstruksionin e banjove te kopshteve		
B: Menaxheriale		
1. Përgatitja e planit për rikonstruksionin e banjove te kopshteve nga Drejtoria e planifikimit dhe investimeve. Plani do të përmbajë numrin e kopshteve që do të rikonstruktohen banjot;		
2. Hapja e procedurës së prokurimit publik:		

3. Përzgjedhja e operatorit ekonomik, firmosja e kontratës dhe realizimi punimeve;

C: Infrastrukturore

1. Realizimi punimeve dhe marrja ne dorezim

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Hartimi i planit të për rikonstruksionin e banjove te kopshteve;
2. Miratimi i planit në KB;
3. Hapja e procedurës së prokurimit publik;
4. Përzgjedhja e operatorit ekonomik;
5. Realizimi punimeve dhe marrja ne dorezim.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Shërbimet higjienike te kopshteve sipas standarteve.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit ;
- Drejtoria e planifikimit dhe investimeve;
- Njësia e Prokurimit Publik.

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Operatori Ekonomik

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026
1	Hartimi i planit të për rikonstruksionin e banjove te kopshteve	Njësia e Arsimit Parashkollor			
2	Miratimi i planit në KB	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
3	Hapja e procedurës së prokurimit publik	Njësia e Prokurimit Publik			
4	Përzgjedhja e operatorit ekonomik dhe realizmi	Njësia e Prokurimit Publik/Operatori	500,000	300,000	300,000

	I investimit	ekonomik			
f) Periudha e zbatimit:		g) Ndjek zbatimin e projektit:			
		Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

Nr. 019	Projekti: Krijimi i kendeve te lojrave per femije ne 3 kopshte	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
- Duke u bazuar te analiza e realizuar per hartimin e planit te permiresimit te sherbimit per arsimin parashkollor eshte verejtur mangesi e kendeve te lojrave per femijet ne kopshte.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
VKM nr. 159, datë 01.03.2017, “Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve”, ka për qëllim që të shërbejë si referencë për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, projektimit/dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesave/hapësirave të reja të kopshteve apo në rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese.		
ii Synimi i projektit		
Ky projekt synon pajisjen e 3 kopshteve me kende lojresh e shperndare ne 3 vite		
iii Niveli i ndërhyrjes		
A: Ligjore		
1. Miratimi i buxhetit per pajisjen me kendet e lojrave per femijet ne 3 kopshte në KB.		
B: Menaxheriale		
1. Përgatitja e planit per pajisjen me kendet e lojrave per femijet ne 3 kopshte nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;		
2. Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik për gjetjen e operatorit ekonomik. Gjetja e operatorit dhe firmosja e kontratës;		
3. Supervizimi i punimeve		
4. Kolaudimi i pajisjeve		

C: Infrastrukturore

1. Pajisja me kende lojrash per 3 kopshte nga operatori ekonomik.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Përgatitja e planit per pajisjen me kendet e lojrave per femijet ne 3 kopshte;
2. Miratimi i buxhetit në KB;
3. Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik dhe gjetja e operatorit ekonomik;
4. Pajisja me kende lojrash per 3 kopshte nga operatori ekonomik.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Kushte infrastrukturore të përshtatshme në kopshtet e Bashkisë Vau Dejës në përshtatje me VKM Nr. 159.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
- Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
- Njësia e Prokurimit Publik

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Operatori ekonomik.

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026
1	Përgatitja e planit per pajisjen me kendet e lojrave per femijet ne 3 kopshte	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit			
2	Miratimi i buxhetit në KB	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
3	Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik dhe gjetja e operatorit ekonomik	Njësia e Prokurimit Publik			
4	Pajisja me kende lojrash per 3 kopshte nga	Operatori Ekonomik	800,000	800,000	800,000

	operatori ekonomik dhe kolaudimi				
f) Periudha e zbatimit:			g) Ndjek zbatimin e projektit:		
			Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit		

Nr. 020	Projekti: Hapja e Kopshtit me dreke	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
<p>- Duke u bazuar te analiza e realizuar per hartimin e planit te permiresimit te sherbimit per arsimin parashkollor dhe te kerkesa e qytetareve ne NJA Vaun e Dejes dhe NJA Bushat gjate degjesave publike te 2023 ka nje kerkese ne rritje nga qytetaret per hapjen e kopshteve ne dreke. Aktualisht nuk ka asnje kopshte me dreke ne territorin e bashkise.</p> <p>-</p>		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
VKM nr. 159, datë 01.03.2017, “Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve”, ka për qëllim që të shërbejë si referencë për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, projektimit/dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesave/hapësirave të reja të kopshteve apo në rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese.		
ii Synimi i projektit		
Ky projekt synon hapjen e dy kopshteve me dreke ne ne NJA Vaun e Dejes dhe NJA Bushat , bazuar në Standardet e VKM Nr. 159.		
iii Niveli i ndërhyrjes		
A: Ligjore		
1. Miratimi i buxhetit për hapjen e dy kopshteve me dreke ne ne NJA Vaun e Dejes dhe NJA Bushat në KB.		
B: Menaxheriale		

1. Përgatitja e planit të përmirësimit të infrastrukturës për hapjen e dy kopshteve me dreke ne ne NJA Vaun e Dejes dhe NJA Bushat nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;
3. Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik për gjetjen e operatorit ekonomik për ndërhyrjet në Kopshte. Gjetja e operatorit dhe firmosja e kontratës;
4. Supervizimi i punimeve në kopshte
5. Kolaudimi i kopshteve

C: Infrastrukturore

1. Përmirësimi i infrastrukturës për hapjen e dy kopshteve me dreke ne ne NJA Vaun e Dejes dhe NJA Bushat nga operatori ekonomik.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Përgatitja e planit të përmirësimit të infrastrukturës për hapjen e dy kopshteve me dreke ne ne NJA Vaun e Dejes dhe NJA Bushat;
2. Miratimi i buxhetit në KB;
3. Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik dhe gjetja e operatorit ekonomik;
4. Përmirësimi i infrastrukturës për hapjen e dy kopshteve me dreke ne NJA Vaun e Dejes dhe NJA Bushat (mobilimi dhe qera per hapesira per kopshtet).

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

2. Hapje e 2 kopshteve me dreke dhe kushte infrastrukturore të përshtatshme në kopshtet e Bashkisë Vau Dejës në përshtatje me VKM Nr. 159.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
- Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
- Njësia e Prokurimit Publik

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Operatori ekonomik.

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026
1	Përgatitja e planit të përmirësimit të infrastrukturës për hapjen e	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të			

	dy kopshteve me dreke ne ne NJA Vaun e Dejes dhe NJA Bushat	Territorit			
2	Miratimi i buxhetit në KB	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
3	Hapja e Procedurës së Prokurimit Publik dhe gjetja e operatorit ekonomik	Njësia e Prokurimit Publik			
4	Përmirësimi i infrastrukturës për hapjen e dy kopshteve me dreke ne ne NJA Vaun e Dejes dhe NJA Bushat	Operatori Ekonomik	3,900,000	4,300,000	800,000
f) Periudha e zbatimit:		g) Ndjek zbatimin e projektit:			
		Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit			

Risqet

Risku	Mitigimi
Risku i mos realizimit të objektivave të vendosura në këtë proces lidhet me mungesën e fondeve të Bashkisë për të financuar projektet.	Do të shihet mundësia e gjetjes së donatorëve dhe/ose rritja e të ardhurave të veta të bashkisë nëpërmjet një Politike Fiskale të caktuar.

4.5 Materialet

4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale

Informacion i përgjithshëm

Përsa i përket materialeve didaktike, drejtueset e kopshteve kanë raportuar nëse kopshtet disponojnë materiale didaktike për çdo fëmijë dhe 12 prej tyre kanë raportuar pozitivisht. Kopshte që nuk disponojnë materiale didaktike për çdo fëmijë janë 8 dhe ndodhen në NjA Bushat dhe Hajmel. Shpenzimet për materiale didaktike mbulohen nga prindërit, ndaj jo të gjitha kopshtet kanë materiale didaktike për çdo fëmijë sepse jo të gjithë prindërit pranojnë të paguajnë për to. Bashkia nuk i pajis kopshtet me materiale didaktike, ajo mbulon vetëm shpenzimet për materiale kancelarike.

Bashkia Vau Dejës nuk ka një listë të unifikuar të materialeve didaktike për fëmijët e kopshteve.

Objektiva kryesore:

Sigurimi i materialeve të nevojshme didaktike dhe kancelarike për të siguruar zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve, bazuar në “Standartet e Zhvillimit dhe të të Nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç”.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Hartimi i një liste të unifikuar të materialeve didaktike për të siguruar zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve, bazuar në “Standartet e Zhvillimit dhe të të Nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç”

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
070	Kopshtet që kanë materiale didaktike për çdo fëmijë (%)	Fshat	%	Tjeter	12	20	20	20
070	Kopshtet që kanë materiale didaktike për çdo fëmijë (%)	Qender	%	Tjeter	12	20	20	20
069	Numri i kopshteve që kanë listë të	Fshat	Vlere	Shumatore	0	20	20	20

Kodi	Indikatori	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
	unifikuar për materialet didaktike të dërguar nga Bashkia							
069	Numri i kopshteve që kanë listë të unifikuar për materialet didaktike të dërguar nga Bashkia	Qender	Vlere	Shumatore	0	20	20	20

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Buxhet Vit 1	Buxhet Vit 2	Buxhet Vit 3
021	Unifikimi i listës së materialeve didaktike për të gjithë kopshtet e Bashkisë Vau Dejës	Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit	2,500,000		2,500,000

Lista e projekteve

Nr. 021	Projekti: Unifikimi i listës së materialeve didaktike për të gjithë kopshtet e Bashkisë Vau Dejës	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Bashkia mundëson mjete kancelarike por jo mjete didaktike. Materialet didaktike financohen nga kontributi vullnetar i prindërve.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Është e nevojshme që të ngrihet një grup pune për të unifikuar dhe vlerësuar listën e materialeve didaktike bazuar në “Standartet e Zhvillimit dhe të të Nxënimit të fëmijëve 3-6 vjeç”.		

ii Synimi i projektit

Materialet didaktike dhe kancelarike janë të domosdoshme në formimin dhe të nxënit e fëmijëve. Për këtë arsye është e nevojshme të ofrohen në sasinë e duhur dhe në cilësinë e duhur. Nëpërmjet këtij projekti synohet të ngrihet një Grup Pune nga Bashkia e Vau Dejës me pjesëmarrje nga mësuesit e kopshteve, punonjës të Bashkisë përgjegjës për arsimin parashkollor, Shërbimet Sociale dhe ZVAP, për të vlerësuar listën e materialeve didaktike, për të krijuar një listë të unifikuar për të gjithë kopshtet dhe të mjaftueshme për procesin e zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve.

iii Niveli I ndërhyrjes

A: Menaxheriale

1. Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit organizon takimin mes mësuesve të kopshteve dhe Njësisë së Shërbimit Social
2. Krijohet një listë e unifikuar dhe e qartë. Lista përmban emrin e materialit, sasinë e nevojshme për fëmijë, markën dhe çmimin;
3. Lista i shpërndahet kopshteve të bashkisë;
4. Prindërit njihen me listën e materialeve didaktike;
5. Bashkia financon materialet didaktike për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale.

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Ngritja e grupit të punës;
2. Unifikimi i listës;
3. Njohja e kopshteve me listën e unifikuar të materialeve didaktike.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Përmirësimi i mjeteve të kopshtit;
2. Përpilimi i një liste finale me të gjitha mjetet që duhet të ketë kopshti dhe çdo fëmijë.
3. Blerja materiale didaktike dhe shpërndarja tyre në kopshte

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
- Njësia e Shërbimit Social

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- ZVAP
- OJF

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026
----	----------	------------	--------------	--------------	--------------

1	Ngritja e grupit të punës	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
2	Unifikimi dhe përmirësimi i listës	Grupi i Punës			
3	Njohja e kopshteve me listën e unifikuar të materialeve didaktike	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			
4	Hapja e procedurës së prokurimit publik	Njësia e Prokurimit Publik			
5	Përzgjedhja e operatorit ekonomik dhe pajisja e kopshteve me materiale didaktike	Njësia e Prokurimit Publik/Operatori ekonomik	2,500,000		2,500,000
f) Periudha e zbatimit: 2024		g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

4.6 Ushqimi

4.6.1 Planifikimi i dietës dhe menysë

Informacion i përgjithshëm

Në bashkinë Vau Dejës nuk ka kopshte të cilat ofrojnë ushqim për fëmijët. Gjatë dy viteve të ardhshme 2024-2025 prioritet për bashkinë Vau Dejës është hapja e 2 kopshteve me drekë në Njësine Administrative Bushat dhe Vau Dejës. Janë zgjedhur këto zona pasi janë më afër dhe më qendrore për tu aksesuar më lehtësisht nga fëmijët dhe ka nje kerkese nga banoret.

Objektiva kryesore:

Mbulimi i kërkesës për shërbimin e ushqimit në kopshte

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Plotësimi i kërkesës për shërbimin e drekës në qytetin e Bushatit dhe Vau Dejës

Indikatorët e performancës

Kodi	Indikator	Shpërndarja gjeografike	Matje ne:	Agregimi	Fakt Aktual	Plan Vit 2024	Plan Vit 2025	Plan Vit 2026
081	Numri i fëmijëve që nuk konsumojnë drekë të regjistruar në kopshtet me drekë	Qytet	Vlere	Shumatore	532	452	372	372
066	Numri i fëmijëve që flenë çdo ditë në kopshte	Qytet	Vlere	Mesatare	0	80	160	160
065	Numri i fëmijëve që konsumojnë çdo ditë ushqimin në kopshte	Qytet	Vlere	Mesatare	0	80	160	160
064	Numri i kopshteve me ushqim	Qytet	Vlere	Shumatore	0	1	2	2
063	Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet me ushqim	Qytet	Vlere	Shumatore	0	80	160	160

Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes	Buxhet Vit 2024	Buxhet Vit 2025	Buxhet Vit 2026
022	Hapja një kopshti me drekë në qytetin e Bushatit dhe Vau Dejës	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit.	4,982,000	9,142,000	9,142,000

Lista e projekteve

Nr. 022	Projekti: Hapja një kopshti me drekë në qytetin e Bushatit ose Vau Dejës	Programi Buxhetor: 09120 - Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor Funksioni: 09
a)Përshkrim i shkurtër i projektit		
i Situata		
Në Bashkinë Vau Dejës nuk ka asnjë kopsht i cili ofron shërbimin me ushqim për fëmijë të moshes 3-6 vjec për këtë arsye për shkak të kërkesave për një kopsht me drekë, bashkia Vau Dejës gjatë dy viteve të ardhshme ka planifikuar hapjen e një kopshti me drekë në Njësinë Administrative Bushat ose Vau Dejës.		
Përmbledhje e problematikës dhe nevoja për ndërhyrje		
Kërkesa për shërbimin e drekës në kopshte është e lartë. Për këtë arsye, është e nevojshme që të paktën të hapet një kopsht në qytetin Bushat ose Vau Dejës		
ii Synimi i projektit		
Hapja e një kopshti me drekë dhe të plotësohet kërkesa e lartë për këtë shërbim.		
iii Niveli i ndërhyrjes		
A: Ligjore		
<ol style="list-style-type: none"> Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit përcakton kostot e ushqimit së një kopshti me drekë; KB miraton buxhetin për ushqimin në kopsht me drekë. 		
B: Menaxheriale		
<ol style="list-style-type: none"> Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse punëson sipas nevojës 1 kuzhinierë dhe mësues ndihmës që do të jenë prezent gjatë kohës së shërbimit të vakteve; Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit nënshkruan kontratën me 		

Operatorin Ekonomik që do të furnizojë kopshtin me ushqim.

C: Infrastrukturore

1. Operatorin Ekonomik fillon te furnizojë kopshtin me ushqim:

iv Aktivitetet kryesore të projektit

1. Përcaktimi i kostove të ushqimit të një kopshti me drekë (vleresim paraprak 200 leke /80Femije/260Dite = 4,160,000 Leke ne vit;
2. Miratimi në KB;
3. Punësimi i burimeve njerëzore të nevojshëm. Paga/kuzhiniere është 34.5 mijë lekë. Paga për 1 mësues mbështetëse është 34 mijë lekë.
4. Hapja e kopshtit me drekë.

b) Rezultatet që prisni (shërbimet apo produktet e pritshme)

1. Plotësimi i kërkesës për shërbimin e ushqimit në kopshte;
2. Rritja e regjistrimit të fëmijëve në kopshtet publike.

Aktorët e mundshëm: (njësitë e përfshira brenda bashkisë)

- Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
- Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Kontributet e mundshme në projekt (institucione qendrore, OJF, donator, etj.)

- Operatori Ekonomik

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm pika iv)

Nr	Emertimi	Pergjegjes	Buxheti Viti 2024	Buxheti Viti 2025	Buxheti Viti 2026
1	Përcaktimi i kostove të shtimit të ushqimit ne një kopshti me drekë	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit /Drejtoria Ekonomike e Arsimit			
3	Miratimi në KB	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit			

4	Punësimi i burimeve njerëzore të nevojshëm	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	822,000	822,000	822,000
5	Furnizimi me ushqim në kopsht me drekë	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit /Operatori ekonomik	4,160,000	8,320,000	8,320,000
			4,982,000	9,142,000	9,142,000
f) Periudha e zbatimit: 2025			g) Ndjek zbatimin e projektit: Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit		

4.7 Buxheti

Zinxhiri	Procesi		Projekti	Buxhet Viti 1	Buxhet Viti 2	Buxhet Viti 3
Regjistrimi i fëmijëve	Regjistrimi i fëmijëve në kopsht	1	Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti	10,000	10,000	10,000
		2	Krijimi i platformës digjitale e cila përmban të dhëna analitike për kopshtin	100,000	100,000	100,000
		3	Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo Kopsht	1,500		
		4	Vlerësimi i brendshëm i kopshteve	70,000	70,000	
		5	Regjistrimi në kopsht sipas banimit			
		6	Punësimi i një specialisti pranë Sektorit të Arsimit vetëm për arsimin parashkollor	732,000	732,000	732,000
Organizmat e Institucionit Arsimit	Këshilli i Prindërve	7	Themelimi i Këshillit të Prindërve			
		8	Fuqizimi i Këshillit të Prindërve	80,000		80,000
	Bordi i Kopshtit	9	Themelimi i Bordit të Kopshtit			
		10	Fuqizimi i Bordit të Kopshtit	80,000		80,000
		11	Ngritja e një strukture lidhëse mes Bashkisë dhe kopshteve			
	Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	12	Ngritja e Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit			

		13	Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	80,000		80,000
Fëmijët me aftësi të kufizuar	Fëmijët me aftësi të kufizuar	14	Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me AK përmes mbështetjes psiko-sociale të prindërve dhe mësuesve (trajtime)	150,000		
	Fëmijët me aftësi të kufizuar	15	Vendosja e rampave dhe respektimi i standardeve për infrastrukturën e fëmijëve me AK pranë institucioneve arsimore	200,000	200,000	200,000
		16	Ofrimi i shërbimit psikosocial për fëmijët me AK	4,248,000	4,248,000	4,248,000
Burimet Njerëzore	Rekrutimi i stafit	17	Zbatimi i Udhëzimit Nr. 14 për punësimin e drejtorëve për kopshtet për 5 grupe fëmijësh	666,000	666,000	666,000
Menaxhimi i godinave	Rikonstruksioni i objekteve	18	Rikonstruksion i banjove te kopshteve (20 banjo)	500,000	300,000	300,000
		19	Krijimi i këndeve të lojrave për fëmijë në kopshte	800,000	800,000	800,000
		20	Hapja e Kopshtit me dreke (2 kopshte NJA Vau i Dejes dhe NJA Bushat)	3,900,000	4,300,000	800,000
Materialet	Planifikimi i nevojës për materiale	21	Unifikimi i listës së materialeve didaktike për të gjithë kopshtet e Bashkisë Vau Dejës	2,500,000		2,500,000
Ushqimi	Planifikimi dietës dhe menysë	22	Punësimi i burimeve njerëzore të nevojshëm	822,000	822,000	822,000

		(kuzhiniere)			
	23	Furnizimi me ushqim në kopsht me drekë	4,160,000	8,320,000	8,320,000
Totali			19,099,500	20,368,000	19,538,000